

URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE
BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE
NR.137 SHKURT 2020



Besimi në Zot, na mban të lirë!



Faqe 19

Nder për klerikët bektashianë!



Faqe 22-23

KUVENDI I DASHURISË



Faqe 24

REDAKSIA:

KRYEREDAKTOR

Syrja Xhelaj

REDAKTORË

Nuri Çuni
Kujtim Boriçi

KORRESPONDENTËT

Jakup Gjoca - Greqi
Eugen Shehu - Zvicër
Përparim Kapllani - Kanada
Agim Cani - Gjermani
Enea Muhameti - Itali

KONSULENTË

Arian Leka
Zenel Anxhaku
Blerina Harizaj
Agim Zeka
Besnik Anxhaku

DESIGN

Studiograf "A&N"

**SHTYPET NË
SHTYPSHKRONJËN**

"Urtësia
Bektashiane"

Shkurt, 2020



Na bëj të qëndrueshëm...



*S*ot, në fund-janarin e vitit 1930, Sali Niazi Dede
Ska shkelur në plloçat e oborrit të kësaj teqeje.
Kishte zbritur në portin e vogël të Sarandës...





Dashuri e vëllazëri për të gjithë

Herët në mëngjes në teqenë e baba Xhemalit u mbledhën klerikët, myhibët dashamirësit për të përkujtuar baba Sherifin dhe themelimin e teqesë së Elbasanit. Mirëseardhjen në teqe e bënë drejtuesit e teqesë baba Faik Selmani...



Krenaria e Jugut të Shqipërisë

Udhëtimi nga Tirana për në teqenë e Zallit ishte e veçantë, sepse do organizohej veprimtaria përkujtimore, për 240 vjetorin e themelimit të kësaj teqeje të famshme, që bëri histori, jo vetëm për Jugun e Shqipërisë...




Besimi në Zot, na mban të lirë!

Me ftesë të Departamentit Amerikan të Shtetit, në muajin shkurt të këtij viti, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, së bashku me lider fetarë nga e gjithë bota, mori pjesë në veprimtarinë e përvitshme të Lutjeve të Mëngjesit, në Shtetet e Bashkuara...



Solidaritetet dhe humanizëm njerëzor

Qysh në orët e para të mëngjesit, të tërmetit të datës 26 nëntorit, Kryegjyshata Botërore Bektashiane me Seli në Tiranë jetoi minutat e humbjeve të mëdha njerëzore. Kryegjyshi, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj dërgoi mesazhin për të prekurit nga tërmeti dhe ngushëllime për familjet e viktimave.



// Përkujtohet jubileu i 90-të vjetorit të ardhjes në Shqipëri të Kryegjyshit Botëror Bektashian, Sali Niazi Dede //

Na bëj të qëndrojmë në udhën e vëllazërimit



Si sot, në fund-janarin e vitit 1930, Sali Niazi Dede ka shkelur në pllaçat e oborrit të kësaj teqeje. Kishte zbritur në portin e vogël të Sarandës, ishte pritur aty nga dervishë e baballarë të Gjirokastrës, pastaj, nën shoqërimin e tyre iu drejtua Korçës. Bashkë me baballarët e Jugut të Shqipërisë, në Përmet e Kolonjë, qindra dashamirës të besimit, iu afruan duke i puthur duart këtij biri të këtyre anëve, që

vinte me misionin e madh, të mbante të pafikur dritën e kandilit të Haxhi Bektash Veliut. Fati e kishte dashur që shqiptarët të kishin në gjirin e tyre një xhevahir të rrallë, një qendër të filozofisë dhe praktikave bektashiane, e cila do të rrezatonte këtë e tutje jo thjeshtë ekzistencën e një tarikati, por edhe një frymë paqeje e vëllazërie në Shqipëri e krejt Ballkanit.

Për të nderuar këtë jubile lavdiplotë, në këtë ditë

Qeshëm, vërtetë!

Janari, kanë ardhur në teqenë e Turanit, në Korçë, qindra besimtarë. Ka prej tyre që kanë dëgjuar nga prindërit për Sali Niazi Dede, por ka dhe të rinj që mrekullohen duke parë fotot e një ekspozite të çelur enkas për këtë ditë dhe ku biri i Kolonjës, gjendet gjithmonë i qeshur, i rrethuar prej vëllezërve bektashianë të asaj kohe. Ka të ardhur nga fshatrat e Korçës që sidoqoftë flasin me njeri-tjetrin për hallet e ditës. Se oborret dhe odat e teqeve bektashiane kështu kanë qenë jetë pas jete, bartëse të meditimeve të thella për Zotin, vëmendje ndaj fjalës së urtë të baballarëve, shpresë për brengat e hallexhinjve. Në këtë teqe, qiellorja dhe tokësorja përmes ndërthurjeve të çuditshme shpirtërore, kanë mbajtur gjallë besimin, në breza të tërë.

Nuk mungojnë në këtë ditë të veçantë për bektashinjtë edhe përfaqësuesit fetarë të Korçës, të cilët duan të ndajnë me vëllezërit e tyre, emocionet e festës. Myftiu i qytetit, Ledion Cikallesi, eurudit në rrafshin e studimeve të Islamit në Shqipëri, duke uruar, rrëfen për këtë ditë se ngjarja nuk qe rastësi. Fill pas shpalljes së pavarësisë, atdhetarët shqiptarë e kuptuan se duhej larguar sa më parë prej prirjeve të perandorisë osmane, thotë ai, duke vijuar më tej, se reformat e komunitetit mysliman shqiptar, të drejtuar nga Haxhi Vehbi Dibra, ishin parakushtet e ushtrimit të një besimi tradicional, sipas të parëve tanë. Gjithmonë në këtë rrafsh, ai sheh edhe përpjekjet e baballarëve bektashianë të atyre viteve, si edhe respektin e thellë të krejt besimtarëve, për veprën e pavdekshme të Sali Nizai Dede.

Në auditorin modest në oborrin e teqesë, pas ekze-

Në auditorin modest në oborrin e teqesë, pas ekzekutimit të himnit të flamurit kombëtar, ishte Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili, pasi falënderoi të pranishmit, tha midis të tjerave: "Plot 90 vite më parë, tek ky oborr ku jemi mbledhur sot, shkeli këmba dhe u dëgjua zëri i ngrohtë i Sali Niazi Dedeit, i birit të hershëm të Kolonjës, i klerikut që u rrit dhe u edukua me traditën bektashiane, për të arritur në postin e lartë të Kryegjyshit Botëror, në Kryeqendrën Bektashiane në New-Shehir të Turqisë.

kutimit të himnit të flamurit kombëtar, ishte Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, i cili, pasi falënderoi të pranishmit, tha midis të tjerave: "Plot 90 vite më parë, tek ky oborr ku jemi mbledhur sot, shkeli këmba dhe u dëgjua zëri i ngrohtë i Sali Niazi Dedeit, i birit të hershëm të Kolonjës, i klerikut që u rrit dhe u edukua me traditën bektashiane, për të arritur në postin e lartë të Kryegjyshit Botëror, në Kryeqendrën Bektashiane në New-Shehir të Turqisë. Ndonëse pritja që populli i jugut të Shqipërisë i bëri Sali Niazi Dedeit ishte e pazakontë, ndonëse besimtarët bektashinj të Kolonjës dhe Korçës e shoqëruan atë me entuziazëm nga Qafa e Qarrit dhe deri këtu, ndonëse atmosfera qe vërtetë vëllazërore, kjo nuk do të thotë e rrugëtimi dhe vendimi i atij burri kishin qenë të lehtë. Ai klerik i dhembshur, i mëkuar me devotshmërinë ndaj Zotit përmes filozofisë së Haxhi Bektash Veliut, kishte kapërcyer pak kohë më parë pragun e teqesë së bekuar të New-Shehirit, duke lënë pas jo vetëm pikëllimin dhe heshtjen e thellë, por edhe një dëshmi të rrallë, 700-vjeçare të tarikatit bektashian. E nisur qysh në vitin 1826,



mënxyra ndaj bektashizmit, pabesitë dhe krimet mbi 'të, qindra mijëra ndjekës të vrarë, do të ishin të denja të vendoseshin në krah tragjedi të Shekspirit. Perandoria otomane, ndonëse përjetonte fundin e palavdishëm të sajë, ishte gati të bënte gjithçka për të zhdukur nga familja myslimane tarikatin bektashi, ndonëse ky tarikat dikur, kishte frymëzuar vetë sulltanët. Sidoqoftë ardhja në Shqipëri, e Kryegjyshit Botëror Bektashian, e burrit nga Starja e Kolonjës, i cili kishte ditur të udhëhiqte mrekullisht teqetë bektashiane në gjithë botën, ishte një vullnet dhe dëshirë e Zotit. Por këtë vullnet, e përmbushën deri në fund, përpjekjet dhe sakrificat e mijëra klerikëve dhe besimtarëve bektashi të trojeve shqiptare në krejt Ballkanin, të cilët me frymën e vëllazërisë që shpërndanin, pranuan në gjirin e madh të tyre, Kryegjyshit Botëror Bektashiane. Ndofta ne shqiptarët e merituum këtë fakt, jo thjeshtë nga prejardhja biologjike e Niazi Dede, por edhe pse teqetë tona, ditën të ruanin e të zhvillonin traditat më të vjera bektashiane, substancën kryesore të tarikatit që është dashuria për Zotin dhe vëllanë që ke në krah, pavarësisht etnisë, racës, apo identitetit fetar. Në rrjedhën e ngatërresave ballkanike të viteve 20 të shekullit të kaluar, por edhe të ngjarjeve në Shqipëri në vitin 1929, ne nuk mund të lemë sot, jashtë vëmendjes, kontributin e çmuar të Mbretit Zogu i Parë dhe Qeverisë Shqiptare të kohës, pa vullnetin e të cilëve gjërat nuk mund të shkonin kaq mrekullisht. Në Arkivin e Shtetit Shqiptar, janë një sërë

Perandoria otomane, ndonëse përjetonte fundin e palavdishëm të sajë, ishte gati të bënte gjithçka për të zhdukur nga familja myslimane tarikatin bektashi, ndonëse ky tarikat dikur, kishte frymëzuar vetë sulltanët. Sidoqoftë ardhja në Shqipëri, e Kryegjyshit Botëror Bektashian, e burrit nga Starja e Kolonjës, i cili kishte ditur të udhëhiqte mrekullisht teqetë bektashiane në gjithë botën, ishte një vullnet dhe dëshirë e Zotit. Por këtë vullnet, e përmbushën deri në fund, përpjekjet dhe sakrificat e mijëra klerikëve dhe besimtarëve bektashi të trojeve shqiptare në krejt Ballkanin, të cilët me frymën e vëllazërisë që shpërndanin, pranuan në gjirin e madh të tyre, Kryegjyshit Botëror Bektashiane. Ndofta ne shqiptarët e merituum këtë fakt, jo thjeshtë nga prejardhja biologjike e Niazi Dede, por edhe pse teqetë tona, ditën të ruanin e të zhvillonin traditat më të vjera bektashiane, substancën kryesore të tarikatit që është dashuria për Zotin dhe vëllanë që ke në krah, pavarësisht etnisë, racës, apo identitetit fetar.



dokumentesh që bëjnë fjalë jo thjeshtë për dëshirën e Mbretërisë Shqiptare që Qendra Botërore Bektashiane të vendosej në Shqipëri, por edhe ndihma konkrete, institucionale që do t'i jepej këtij tarikati në marrëdhënie me shtetet e tjerë. Tek e fundit, burrat e shtetit të asaj kohe, e patën kuptuar se me mëvetësinë e komunitetit mysliman të Shqipërisë nga Turqia, me shpalljen e pavarësisë së kishës ortodokse shqiptare, si dhe me vendosjen në Shqipëri të Kryegjyshit Botërore Bektashiane, ndjenjat tona kombëtare do të lidheshin dhe rriteshin të kulluara, duke na kujtuar të gjithëve devizën e përjetshme: "Pa atdhe, nuk ka fe!". I gjithë shtypi shqiptar i asaj kohe, por në mënyrë të veçantë "Gazeta e Korçës", i bëri jehonë të madhe ardhjes në këtë teqe, të Sali Niazi Dedeit, duke nënkuptuar me këtë rast jo thjeshtë jo thjeshtë vizitën e një kleriku në atdheun e vet, por rëndësinë e misionit që ai mbartte mbi supe. Ai u prit ndërkaq me dashuri e respekt

të veçantë edhe nga përfaqësuesit më të lartë të gjyshit Bektashiane në Shqipëri, Kosovë e Maqedoninë Veriore, të cilët po në këto teqe, pak muaj më parë, në Kongresin e Tretë Bektashian, me idetë dhe votën e tyre të lirë, patën sanksionuar largimin e tarikatit nga dogmat dhe perceptimet e Turqisë, mëvetësinë e tij përmes ruajtjes së traditave, si dhe përkrahjes së çdo nisme kombëtare. Në krye të këtyre klerikëve, në këtë teqe, i rrethuar kurdoherë nga dashamirësia e besimtarëve korçarë, por edhe nga vëllazëria e përfaqësuesve të krishterë e syni të qytetit, Sali Niazi Dede, në pak muaj, mundi të njihet me situatën e teqeve brenda dhe jashtë kufijve politikë të Shqipërisë, me problemet e tyre, me shqetësimet e gërshetuara prej hallevë që kalonte kombi. Në atë dhomë përdhese të kafe oxhakut të teqesë, ai do të priste e përcillte klerikë, besimtarë, intelektualë dhe burra shteti, ndërsa natën vonë, pena e tij, do të projektonte të nesërmen plot dritë të Qendrës Botërore

Bektashiane. Pikërisht këtu, në fundmarsin e vitit 1930, klerikë dhe besimtarë korçarë u gëzuan ndërsa merrnin në duar telegramin e Ministrisë së Drejtësisë, në të cilin thuhej tekstualisht: "Përgjigje e shkresës me numër 32, datë 5 mars 1930. Ju njoftohet se, sipas shkresës Nr. 323, datë 20 mars 1930, të Ministrit të Oborrit Mbretëror, Nalt-Madhnija e Tij Mbreti, pati kënaqësinë me urdhnue dekretimin e emërimit të Hirësisë së Tij, Sali Niazi Dedei, Kryegjysh i Bektashinjve. Dekreti relativ ju dërgohet bashkangjit për t'iu dorëzuar të sipërpërmendurit. Kryeministri, Pandeli Evangjeli." Me këtë akt institucional, Mbretëria Shqiptare, i bënte veç të tjerave një nder të madh, gati historik, jo thjeshtë bektashinjve në trojet shqiptare, por gjithë komuniteteve të këtyre besimtarëve në të gjithë botën. Një Qendër Botërore e një tarikati, e mbyllur me dhunë dhe masa të egra represive në Turqi, tani çelej në Shqipëri jo vetëm e respektuar, por e përkrahur sinqerisht në misionin e vet aq fisnik. Në muajt dhe vitet që rrodhën më pas, Selia Bektashiane në Tiranë, e drejtuar nga Sali Niazi Dede, por në bashkëpunim të plotë institucional dhe harmoni me të gjitha gjyshit, mundi të ngrihet në lartësinë e përgjegjësive që diktonte koha. Në Arkivin e Shtetit Shqiptar, por edhe në arkivin tonë, ekziston një dokumentacion i plotë që nxjerrë në pah konsolidimin e misionit të Selisë Bektashiane. Klerikë dhe myhibanë të shumtë nga Serbia, Kosova, Bullgaria, Maqedonia Veriore, Greqia dhe deri në Egjipt, i shkruajnë me përlulje të thellë shpirtërore Kryegjyshit në Tiranë, duke i kërkuar mendimin e tij të çmuar dhe jo rrallë ndihmë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme fetare. Me intuitën dhe vizionin e tij, Sali Niazi



Dede mundi t'i forcojë këto lidhje, gjithmonë në optikën e interesave botërore të bektashinjve. Ndonëse kanë kaluar plot 90 vite nga ardhja e Sali Niazi Dedeit në këtë teqe, kujtimet e të gjithëve ne janë të shtrenjta. Sepse ka qenë i shtrenjtë besimi i Haxhi BektashVeliut tek çdo klerik e besimtar bektashian, sepse ky tarikat ka bashkëjetuar kurdoherë me hallet e kombit. Ndonëse dora vrastare, mori jetën e Sali Niazi Dedeit më 28 nëntor 1941, besimi ynë as u tremb e as u tkurr. Përkundrazi, pasuesit e Sali Niaziut lanë të gjithë, gjurmë të çmuara. Emrat e Ali Riza Dedeit, Kamber Ali Dedeit, Xhaferr Sadik Dedeit, Abaz Ilmi Dedeit, Ahmet Myftar Dedeit si dhe Hazhi Dede Reshat Bardhit, do të ndriçojnë kurdoherë në panteonin e bektashizmit botëror. Në mënyrë të veçantë, Ahmet Myftar Dedei dhe Dede Reshat Bardhi, do të mbahen mend pse mbajtën të gjallë besimin në Zot, pikërisht në kohërat më të vështira të tij, në vitet e diktaturës

që lamë pas. Nga ky takim i sotëm vëllezërisht, gjej rastin t'ju siguroj ju dhe besimtarët e kudondodhur ën botë se Selia e Shenjtë Bektashiane, e ngritur mbi gjakun, sakrificat, duke u shndërruar jo thjeshtë në një institucion paqeje të përjetshme, por edhe në mision për vëllazërinë fetare, kudo ku fryma e saj, gjallëron komunitetet e besimit tonë. Ne do të bëjmë ç'të jetë e mundur që shqiptarët e sotëm të mos lenë teqetë, të mos lenë xhamitë dhe kishat për t'u larguar nga atdheu, por të bashkohemi rreth shpresës për një Shqipëri të denjë. Kohërat janë të vështira, por ne kemi besim tek Zoti i Lartë!.."

Përsëndetje të ngrohta janë përcjellë paskëtaj edhe nga autoritetet e pushtetit vendor të Korçës, si edhe përfaqësuesit e komuniteteve fetare. Përmes dëgjimit të këtyre fjalëve të çiltra, e para ide që më vjen ndërmend, është pikërisht se çdo përvjetor, për cilindo klerik apo ngjarje fetare, është para së gjithash

një obelisk i devocionit që duhet të kemi ndaj Krijuesit, sepse vetëm përmes mëshirës së Tij, mund t'i jetojmë këto ditë. Natyrisht, memoria na vlen të gjithëve, por jo thjeshtë si një kujtim i bukur. Më tepër, se kaq, memoria, na mban të lidhur fort me traditat më të mira të qindra viteve vetëmohim. Në këtë kuptim nuk ka më filozofike se ideja e Imam Gazaliut të shekujve më parë kur thoshte se çdo frymëmarrje, duket vlerësuar dhe shihe këtë botë të përkohshme, sikur do të vdesësh nesër. Dhe pastaj në meditimin më të thellë dhe të çiltër lutej: "O Zoti im! Na e përfundo jetën tonë me lumturi, na e cakto si pjesë shikimin e bukurisë tënde dhe pëlqimin Tënd. Bëje devotshmërinë ushqim për ne dhe orientoje mbështetjen dhe besimin tonë, tek Ti. Na bëj të qëndrueshëm në udhën e vërtetë! Vetëm Ti je i denjë për adhurim!"

**Syrja Xhelaj, Turan-Korçë,
janar 2020**


Pritja e një burri të shquar

Nga Nuri Çuni

Kur parlamenti turk, me vendim të veçantë, në dhjetor të vitit 1925 urdhëroi mbylljen e të gjitha teqeve në Turqi, Sali Niazi Dedei i hodhi sytë nga atdheu i tij, Shqipëria. Bektashinjtë e kanë dashur dhe duan deri në përkushtim tokën që i lindi. Bie në sy letërkëmbimi i Kryegjyshit Botëror dërguar më 10 mars 1929, Sabri Qytezës, ku kërkohet të merren masa për vendosjen e Kryegjyshit Botëror Bektashianë në Shqipëri, pasi ajo u mbyll në Turqi. Pas disa konsultimesh me konsullatën shqiptare në Stamboll dhe klerikët shqiptarë në Shqipëri dhe Mbretin Zog, për transferimin e Qendrës Botërore Bektashianë në Shqipëri, e cila ishte një ogur i mirë, Sali Niazi Dede, duke u këshilluar edhe me këshillat gjyshërore nëpër vende të ndryshme, mori vendimin e duhur dhe erdhi në Shqipëri.

Dihet që kongreset bektashianë luajtën rol të rëndësishëm në jetën dhe organizimin strukturore në vite të bektashizmit në Shqipëri ndikuan ndjeshëm jo vetëm në gjirin e vet por edhe në demokratizmin e jetës së vendit e këtë shembull e dha kongresi i parë bektashian në Prishtë të Skraparit, 14-17 janar të vitit 1921. Kongresi i parë bektashian i Prishtës, në Skrapar ishte i veçantë sepse dhe rrethanat historike që po kalonte vendi ynë, lufta dhe përpjekjet e patriotëve shqiptarë për çështjen e kombëtarizimit të institucioneve fetare dhe pavarësimi i plotë i tyre ishte pjesë e procesit historik të konsolidimit të shtetit shqiptar si një pjesë substanciale të ndërtimit të shtetit kombëtar dhe të plotësimit të ndërtimit të kombit modern shqiptar në të gjitha qelizat e tij sociale, shpirtërore, kulturore dhe politike. Formimi i Komunitetit Bektashian Shqiptar nga ky Kongres ishte pjesë e kontributeve të bektashinjve në shekuj. Falë vendimeve historike të Kongresit të Lushnjës në janar të vitit 1920 që mori në mbrojtje besimet fetare dhe që ishte parlamentarizmi i parë shqiptar. Bektashizmi shqiptar filloi organizimin e tij me statut dhe Këshill Klerikal duke e forcuar atë vit pas viti. Për kongreset bektashianë është njohur edhe Kryegjyshi Sali Niazi Dede.

Një tjetër ngjarje me rëndësi për bektashinjtë e Shqipërisë ka qenë Kongresi i tretë bektashianë mbajtur më 26 shtator të vitit 1929, në teqenë e Turanit - Korçë ku midis të tjerave u



vendos në statutin e tij në: ... “ Dispozita transitore. Art. 57 “Qendra e përkohshme me Komunitetin fetar Bektashian është Teqeja e Shenjtë e Turanit (Korçë)”. Për këtë ishte në dijeni Sali Niazi Dede dhe mbasi mbaroi dorëzimin e Qendrës në Haxhi Bektashit (sot e kthyer në një muze) u mor me problemet e tjera në Ankara të bektashizmit dhe u përgatit për të ardhur në Shqipëri.

Në janar të vitit 1930 sipas dokumenteve të arkivave burri dhe kleriku I shquar u nis me vaporin “Ekspres” nga Stambolli në Pire-Greqi në një udhëtim prej rreth 22 orë. Më pas për në Sarandë udhëtim 24 orë mbërriti në skelën e Sarandës. Këtu u prit nga një komision i posa-

çëm prej 17 bektashinj të shquar klerik dhe laik. Si delegatë të Korçës ishin baba Ramadan Qatromi, baba Zylfo Melçani, zoti Et`hem Osmani e Ali Koprëncka, që të dy deputet në atë kohë. Kamber Babai i teqesë së Prishtës, Sulejman Babai i teqesë Shtufit, dervish Rexhebi, dervish i Selim Babait, të Gjirokastrës, Hysni Baba i teqesë Turanit-Tepelenë, Hasan Baba i teqesë Memaliaj, Xhafer Baba i teqesë Përmetit, Seit Baba i teqesë Leskovik, Ali Baba i teqesë Kulmakut-Skrapar, dervishi i Mustafa Babajt të teqesë së Frashërit si dhe shumë myhib dhe ashikë të tjerë. Prej Sarandës në Gjirokastrë, pasi pinë një kafe në teqenë e Selim Babait, së bashku duke ardhur në teqenë e Sulejmanit të Shtufit, qëndruan një natë mysafirë. Me mall dhe respekt të pritjes në këto teqe, Sali Niazi Dede i shoqëruar nga klerikët e nderuar të kohës vazhduan udhëtimin e përmallshëm në teqenë e Turanit Tepelenë, Sukë, Këlcyrë, dhe tek ajo e baba Xhaferit Përmet. Kurse në Leskovik e pritën Sabri Qyteza, Teufik Lamçe e Teufik Orgocka dhe delegatët e Kolonjës, baba Hajdari, varf Myhtari, Sali Butka dhe të tjerë. Në hyrje të Ersekës pritën Shenjtërinë e Tij, nënprefekti, kryetari i bashkisë, zv. mitropoliti, nëpunësi i financave, gjyqtari paqëtues, komandati i gjindarmërisë, doktori i bashkisë, avokatët dhe parësia e vendit, bektashinj dhe orthodhoksë. Në emër të popullit të Kolonjës vendin e lindjes të Kryegjyshit, Shenjtëri e Tij

u përshëndet me një fjalim entuziast prej avokatit z. Selami Libohova. Pastaj në emër të Kryegjyshit, u përgjigj duke falënderuar Atë Ali Tomorri.

Në Qafën e Qarrit kishin dalë për të pritur këtë burrë të shquar 200 dashamirësit të Ehli-Bejtit.. Grupi që e shoqëronte pasi hipi në makina të vendosura në autokolonë u drejtuan për në qytetin e Korçës, në mbasditen arritën në teqenë e Turanit. Gazeta e Korçës më 1 shkurt 1930, në atë datë historike për bektashinj të Shqipërisë do të shkruante: ...“Kryegjyshi deklaroi se është tepër i mallëngjyer nga pritja e jashtëzakonshme e përzemërt e popullit dhe autorizoi t`i transmetojnë bekimet e tij jo vetëm besnikëve bektashinj por gjithë popullit të Shqipërisë së lirë.” Këtë event të ardhjes të Sali Niazi Dede e shkroi më së miri shtypi i kohës dhe në letrën që i dërgon mikut të tij Ali Naxhi Bajkalit në Turqi. Sigurisht edhe në dokumentet arkivore në vite gjejmë të dhëna për misionin e shenjtë të tij. Ai vinte në atdheun e vet për të mbajtur gjallë tarikatën e vyer të bektashizmit, i cili u godit e rrënuar pareshtur në shekujt e 19 dhe 20 në Turqi. Në një dokument (Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 883, viti 1932, dosja 1, fl. 1 - 3) thuhet: “Kryetari i teqesë së Haxhi Bektash Veliut në Kërshehir, Hirësia e Tij Kryegjyshi Salih Niazi, që është i fisit shqiptar dhe që njihet si Papa i gjithë bektashinjve të botës, u shtrëngua të largohet nga

qendra e madhe e bektashizmit, dhe erdhi e zu vend në Tiranë si Kryegjysh i Shqipërisë, gjithë duke mbajtur dhe ofiqin e tij të lartë si postmbajtës i këtij besimi në gjithë botën”.

Sali Niazi Dede, erdhi në Shqipëri me ide të qartë për rritjen e besimit bektashian, këtu në jugperëndim të Evropës së krishterë. Kjo sfidë do të kalonte vetëm e vetëm përmes mësimëve të Haxhi Bektash Veliut. Sapo vuri këmbën në tokën shqiptare, kleriku i shquar bektashian, provoi përveç frymës tradicionale të besimit edhe atë të besimtarëve të thjeshtë. Në letrën që i dërgon myhridit të tij, baba Ali Naxhi Bajkalit, në ato ditë të fundit të janarit 1930, pasi përshkruan udhëtimin e ardhjes në Shqipëri nga Saranda në Korçë midis të tjerave shkruan: ... “Shkuarja në Turan me njëzetë e pesë makina do të mbetet një kujtim i paharruar dhe shumë i vyer për mua. Do të qëndrojmë disa ditë këtu dhe do të shkojmë në Tiranë për të marrë fermanin e Kryegjyshit”. Vendosja e tij në teqenë e Turanit Korçë, dhe nisja e veprimtarisë intensive për forcimin e bektashizmit në Shqipëri ishte i një rëndësie të veçantë, sepse u bë institucioni i parë bektashianë botëror në Shqipëri. Kjo u shoqërua me takime të Mbretit Zog në muajin shkurt dhe dekretimi i tij si Kryegjysh Botëror i Bektashinjve në mars po të atij viti.

Qeveria e Mbretit Zog duke respektuar vullnetin e klerikëve bektashian me dekret të veçantë e emëroi në mars 1930 Sali Niazi Dedenë, Kryegjysh Botëror të Bektashinjve. Ky akt madhor, sot e kësaj dite, qëndron plot dinjitet midis zgjidhjeve të ndryshme të shqiptarëve, përgjatë historisë së vet, kjo është krenari për gjithë shqiptarët dhe sot në këtë 90 vjetor të ardhjes së tij në Shqipëri është shumë domethënëse dhe e paimagjineshme. Sot ne përulemi me respektin më të thellë ndaj burrave dhe klerikëve të shquar si Sali Niazi Dede, “Dëshmor i Atdheut dhe “Nderi i Kombit” të cilët i bëjnë nder jo vetëm besimit bektashian, por krejt Shqipërisë dhe botës”.



// Perkujtohen dita e themelimit të teqesë së baba Xhemalit dhe kalimi nga kjo botë e baba Sherif Canometaj //

Dashuri e vëllazëri për të gjithë



Herët në mëngjes në teqenë e baba Xhemalit u mblodhën klerikët, myhibët dashamirësit për të përkujtuar baba Sherifin dhe themelimin e teqesë së Elbasanit. Mirëseardhjen në teqe e bënë drejtuesit e teqesë baba Faik Selmani dhe dervish Admiri. Ashtu në varg njeri-pas tjetrit u pritën të gjithë në këtë teqe të hershme. E themeluar nga baba Ali Horasani, kjo teqe nis në shekullin e 17, guri i varrit mban emrin e tij dhe datën e kalimit nga jeta, ishte nga të parët që përhapin doktrinën bektashiane në Elbasan, por dihen pak të dhëna për të. Në regjistrat e vjetër të vakëfit figuron për truallin e saj se “Teqja e baba Ali horasanit ndodhet në anën e lumit Shkumbin, pranë tyrbes së Goces. Për shumë kohë teqeja e baba Ali Horasanit nuk funksionoi. Por e mori emrin teqeja

e baba Xhemalit, një klerik bektashian me origjinë turke, i cili erdhi në Shqipëri, vitin 1925, mbas mbylljeve të teqeve në Turqi. I njohur si baba me përvojë në teqetë e Turqisë, Haxhi Bektash, Stamboll, Bagdad, dijetar me kulturë të, ai në Elbasan ringriti nga themelet teqenë e vjetër të baba Ali Horasanit mbi rrënojat e saj dhe tyrben e baba Ali Horasanit në vitin 1929. Punoji me përkushtim për bektashizmin, mbajti lidhje me teqetë e tjera në Elbasan, Gramsh, Krujë, Martanesh, si edhe Kryegjyshatën Botërore në Tiranë. Ndërroi jetë më 28 shtator 1949, dhe u varros në tyrben e baba Ali Horasanit. Paskëtaj të tjerë vazhduan drejtimin e teqesë klerikët: Baba Ali Riza (1949 - 1953). Baba Sherif Canometi (1953 - 1958, 1963 - 1967). Në vitin 1967 teqeja u mbyll dhe u kthye në institucion shtetëror. U rihap nga baba Sherif



Canometaj më 14 qershor 1993. Baba Sadik Ibro drejtoi teqenë deri në vitin 2004 dhe më pas baba Faik Selmani deri më sot, vijon të ecë në gjurmë të të parëve.

Sigurisht sot në këtë përkujtim merr një rendësi dhe kontributi i shquar i baba Sherifit kujtimi i mrekullueshëm i të cilit i ka mbledhur sot besimtarë nga Elbasani, Tirana, Gramshi, Kavaja, Lushnja, Gjirokastra, Tepelena, Korça, Kruja. Në dhomën e pritjes baba Faiku dhe dervish Admiri pritën me ngrohtësi klerikët Haxhi baba Sadik Ibro, dervish Mikel Onjea, dervish Xhelal Resulin, dervish Sali Peti, kjo është bërë traditë e përvitshme. Morën pjesë përfaqësues të komuniteteve fetare në Elbasan si myftiu i qytetit, Agim Duka, nga komuniteti ortodoks At Stavri Çipa dhe At Gjergj Trebicka, komuniteti katolik Sokol Lulgjuraj dhe përfaqësuesi i komunitetit ndërftuar të Elbasanit, kryetari Arben Ramkaj. Më pas u organizua

ceremonia e Mevludit në mejdanin e teqesë, baba Faiku bëri lutjen e rastit dhe ia dha fjalën Haxhi Baba Sadik Ibro, i cili në emër të Kryegjyshit Botëror, Hirësisë së Tij, Haxhi Dede Edmond Brahamj lexoi lutjen dhe më pas vazhdoi me pjesët e mevludit imam Agim Duka, mevludi i bënë himn dhe adhurim të pashoq profetit Muhamed.

... Është një punë e mirë që të ngrihemi në këmbë

Nderimit për Pejgamberë e të bëjmë ikramë shumë.

Atëherë më erdh një zog erdhi e më ndenji pranë

Më zuri krahët mu bë shok më mbajti dhe harkanë.

Një zog të bardhë ai dërgoi që kish dalë nga xheneti

Eminenë zu e shtrëngoje të lind kollaj Muhamedi...

Në oborrin e teqesë në grumbullin e madh të pjesëmarrësve

grupi polifonik përshëndet me këngë të bukura bektashiane për teqenë e baba Xhemalit dhe baba Sherifit. Kjo atmosferë përkujtimi vazhdoi në drekën e shtruar në restorant "Elbesida" edhe këtu përshëndetën baba Faiku, i cili u ndal për kontributin e shquar të baba Sherifit që e ka njohur edhe nga afër, i cili kaloi një jetë të vështirë dhe të nderuar në shërbim të bektashizmi, në çdo teqe dhe gjyshit ku punoi, ai mbetet pishtar i bektashizmit, i djeshëm dhe i sotëm. Kurse, përfaqësuesi i këshillit ndërftuar për Elbasanin, z. Arben Ramkaj, falënderoi organizatorët e kësaj veprimtarie përkujtimore të themelimit të teqesë baba Xhemalit dhe baba Sherifit, duke shtuar midis të tjerave se ne sot marrim mesazhin e vazhdimësisë të kësaj tradite të hershme bektashiane që nga misionari i parë në zonën e Elbasanit, të baba Ali Horasanit e deri më sot dhe klerikut të shquar baba Sherifit, i cili shkriu jetën e tij

Kronikë e jetës së baba Sherifit

Lindi më 4 gusht 1908 në fshatin Zhapokikë të Tepelenës
 1942 myhib i teqesë Koshtanit-Tepelenë
 1945 dervish në teqenë e Koshtanit
 1945-1947 dervish, kurs për mistikën bektashiane.
 1948-1949, baba në teqenë e Leskovikut
 1949-1953 baba në teqenë e Zallit –Gjirokastrë
 1953-1958 baba në teqenë e baba Xhemali-Elbasan
 1958-1962 baba në teqenë e Martaneshit
 1963-1967 baba në teqenë e Madhe Elbasan
 1967-1992 punëtor krahu në Elbasan
 1992- 1994 baba në teqenë e Baba Xhemalit.

në udhën e bektashizmit që ne sot e përkujtojmë, urimet më të mira gjyshitës së Elbasanit baba Faikut dhe dervish Admirin në këtë traditë bektashiane, e dashurinë për të gjithë.”

Për nipërit dhe mbesat e baba Sherifit, përshëndeti z. Petrit Hysi, i cili midis të tjerave ai tha: “... Si sot 26 vjet më parë, 14 shkurt 1994, baba Sherifi është ndarë nga ne fizikisht, por ai shpirtërisht jeton jo vetëm në zemrat e të afërmeve të tij, por tek të gjithë besimtarët që e kanë ndjerë e dëgjuar nga afër fjalën e urtë e të ngrohte, dashurinë për njeri-tjetrin, paqen e harmoninë në mes njerëzve, shpresën, optimizmin për të ardhmen, prandaj do të kujtohet në jetë

të jetëve sikurse e thotë autori, gdhendur në vargje të këngës labe:

Besimtarët bletë rohinë,
 Gjenin te ti Perëndinë.
 Edhe dielli do të shuhet,
 Po besa jote do të ruhet.

Baba Sherifi i përket asaj plejade që kanë bërë historinë e bektashizmit shqiptar, të udhëhequr kurdoherë nga urtësia e devocioni i prijësit Haxhi Bektash Veliu, i cili me fjalën, mistikën, veprën e jetën e tij, ka lënë gjurmë të pashlyeshme. Personalisht nuk e kam të lehtë dhe nuk mundem të përshkruaj rrugën e gjatë të baba Sherifit e gjurmët e lëna prej tij, shpirtërore e të shpalosjes mistike, tek çdo individ e familje. Në këtë kontekst, mund të them se gjithë

nipërit e mbesat e baba Sherifit ndjehemi krenar, na bëhet zemra mal kur dëgjojmë e vërejmë respektin e mirënjohjen që shprehën për baba Sherifin, i cili edhe pas vitit 1967 mbajti gjallë në kujtesën e njerëzve mistikën bektashiane, dhe ai kultivoi dashurinë mes besimtarëve bektashian e më gjerë, duke fituar zemrat e tyre çka mëshirohet ky virtyt tek mbështetja e tij tek çifti mësues ortodoks Miltiadh e Nea. Baba Sherifi ka qenë shembull me punën në shërbim të njerëzve duke krijuar tek ata një besim të plotë nëpërmjet dashurisë të zemrave të besimtarëve e dashamirësve. Fjala e tij ka qenë emocion për çdo besimtarë e dashamirës çka e bënë atë të përjetshëm, monument të gjallë.”

Dreka kaloi në një dashuri dhe respekt për përkujtimin e baba Sherifit dhe të themelimit të teqesë baba Xhemalit. Në bashkëbisedimin dhe bisedat e ngrohta nga të gjithë pjesëmarrësit e u larguan me mesazhin e kësaj ditë dashuri dhe vëllazëri për të gjithë, në dritën bektashiane të teqesë baba Xhemalit, e cila ka rast të ndjejë krenari të ligjshme, jo vetëm për të kaluarën e saj, por edhe veprimtaritë mbresëlënëse të ditëve të sotme

Koresp. “Urtësia”





Krenaria e Jugut të Shqipërisë

Nga Nuri Çuni

Udhëtimi nga Tirana me shofer Gjergj Dhoska për në teqenë e Zallit ishte e veçantë, sepse do organizohej veprimtaria përkujtimore, për 240 vjetorin e themelimit të kësaj teqeje të famshme, që bëri histori, jo vetëm për Jugun e Shqipërisë po për gjithë Shqipërinë. Në këtë prehtore drejtuan nëntë baballarë të ndritur si: Asim babai, Hasan baba Turku, Sulejman baba Gjirokastra, baba Ali Gega, Haxhi Jahja Baba Kruja, Ibrahim Baba Turku, Hysen Baba Elbasani, Haxhi Ali Haqi, Selim Ruhi baba Elbasani. Nga këta kish vjershetor dhe shkrimtarë. Poezitë me frymë mistike janë interesante dhe i trajton bukur Baba Rexhebi në librin e tij të njohur

“Misticizma Islame dhe Bektashiazma”. Këta lanë gjurmë dhe bën emër në këtë qytet. Ata respektoheshin jo vetëm nga bektashinjtë por edhe nga myslimanët dhe të krishterët. Në mbasditen e të mërkurës na priti me respekt baba Skënderi, sekretari Xhanin Koli dhe stafi i teqesë. Mbas kafes të gjithë së bashku u muarëm me vendosjen e standave të ekspozitës fotografike e pregatitur enkas për këtë përvjetor. Edhe pse binte shi puna nuk u ndërpre, kurse baba Skënderi me buzëqeshje duke punuar edhe vet nxiste të tjerët që të mbaronin çdo punë që duhej bërë për nesër. Erdhën nga Tirana ndërkaq pjestarët e tarikatit kadri, sheh Bujar Horasani dhe tre dervishët e tij, të cilët u pritën nga baba Skënderi dhe në darkën e shtruar në një bashkëbisedim të ngrohtë



dhe vëllazëror që ishte kënaqësi për të gjithë ne. U sollën kujtime nga rihapja e teqesë Zallit në kujtim dhe respekt të Dede Reshatit, i cili është organizatori i parë i rihapjes së bektashizmit në Kryegjyshtë dhe çdo teqe të Shqipërisë, i cili kish një kujdes të veçantë për teqenë e Zallit. Simpoziumi i vitit 2001 me temë: "Gjurmë të bektashizmit në Gjirokastrë", mbetet i gjallë edhe sot. Njëpërmjet kumtesave u hodh dritë për gjurmët e bektashizmit që në hershmëri të shek. XVI e më pas. Por nga biseda u cilësua edhe për vazhdimin e rrugës së dede Reshatit nga baba Mondit, i cili si Kryegjysh Botëror po punon me përkushtim në këtë rrugë me vizione të reja dhe ndërkombëtarizimin e Qendrës Botërore Bektashiane. Në këtë gjyshatë me qendër teqenë e Zallit të bie në sy një rregullim i plotë i ambienteve me dhomën e pritjes, dy dhoma fjetje me gjashtë shtretër, tualeti me të gjitha pajisjet e nevojshme të kohës.

Nën shiun e ftohtë në orën 11 filloi ceremonia e kësaj ngjarje të madhe në një nga sallat e mëdha të teqesë së Zallit, ku u grumbulluan së bashku me Kryegjyshin Botëror, Dede Edmondin dhe klerikët: baba Skënderi, baba Sadiku, baba Faiku, baba Abdyli, dervish Myrtezai, dervish Mikeli, dervish Admiri, si dhe myhib dhe dashamirës të ardhur nga Tirana, Tepelena, Skrapari, Gjirokastra, Elbasani, intelektual dhe studiues, përfaqësues të pushtetit vendor të Qarkut Gjirokastrë. Mbas hymnit kombëtar në fjalën e tij Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve, Hirësia e Tij, Haxhi Dede

Edmond Brahimaj u ndal në historinë e kësaj teqeje: "Do të më lejoni që në cilësinë e Kryegjyshit Botëror Bektashian, t'ju falënderoj për praninë e sotme që lidhet me jubileun e mrekullueshëm të teqesë së Zallit dhe t'ju bekoj e uroj: Paçi kurdoherë fat e mbarësi në familjet tuaja! Zoti i Lartë, dymbëdhjetë imamët, urtësia e Haxhi Bektash Velit dhe ajo e dervishëve dhe baballarëve bektashianë, le t'ju bëhen mbrojtje e shpresë për këto ditë! 240 vite më parë, në këtë vend të bekuar ku jemi mbledhur sot, hodhi themelet e saj, teqeja e Zallit, fare pranë shtëpive të qytetit të gurtë, sipas traditës bektashiane për të qenë një vend i qetë meditimi, por edhe me kopshte ku do të punonin e do të nxirrnin mjetet e jetesës, dervishët edhe baballarët e Hakut. Themeluesi, baba Muhamet Asimi, pasi kishte marrë dorë në Haxhi Bektash të Turqisë, pasi kishte bërë zjaret në tyrbet madhështore të Imam Aliut a. s, Imam Hysenit a. s dhe Abaz Aliut a.s, erdhi të mbillte në këtë vend të gurtë, dashurinë dhe devocionin e shenjtë për Zotin, për njerëzit, për kombin. Atij do t'i bashkoheshin në këtë sipërmarrje shpirtërore, burra të shquar dhe atdhetarë jo vetëm nga qyteti i Gjirokastrës, por edhe nga Libohova, Delvina dhe Janina.

Teqeja e Zallit erdhi duke u rritur, së pari me dervishë, myhibë dhe dashamirës e, mandej edhe me pasuri të tjera. Pas baba Muhamet Asimit, këtu erdhën baba Hasan Turku, baba Sulejman Brisku nga Gjirokastra, baba Ali Plaku, të cilët falë euridicionit në

Teqeja e Zallit erdhi duke u rritur, së pari me dervishë, myhibë dhe dashamirës e, mandej edhe me pasuri të tjera. Pas baba Muhamet Asimit, këtu erdhën baba Hasan Turku, baba Sulejman Brisku nga Gjirokastra, baba Ali Plaku, të cilët falë euridicionit në Islam, por edhe njohurive të thella në tarikat, mundën të afrojnë breza të tërë besimtarësh dhe t'i drejtojnë ata në udhën e duhur. Vit pas viti, teqeja u shtua jo vetëm me mejdanin e madh, me kafeoxhakun e mrekullueshëm, por edhe me dhomat e larta prej guri ku jetonin dervishë e baballarë, ku pritëshin e përcilleshin besimtarë, sipas traditës së Haxhi Bektash Velit.

Islam, por edhe njohurive të thella në tarikat, mundën të afrojnë breza të tërë besimtarësh dhe t'i drejtojnë ata në udhën e duhur. Vit pas viti, teqeja u



shtua jo vetëm me mejdanin e madh, me kafeoxhakun e mrekullueshëm, por edhe me dhomat e larta prej guri ku jetonin dervishë e baballarë, ku pritëshin e përcilleshin besimtarë, sipas traditës së Haxhi Bektash Veliut.

Goditja e fuqishme, gati rrënuese që regjimi otoman u dha teqeve bektashiane në vitin e largët 1826 u ndje si në gjithë Turqinë e Ballkanin, edhe në viset jugore të Shqipërisë. Dokumente të shumtë arkivorë bëjnë me dije se me ferman të Portës së Lartë, pjesa më e madhe e teqeve u shkatërruan dhe ata klerikë-ndjekës të Haxhi Bektash Veliut që kundërshtuan, ose u vranë, ose u dërguan në internime, në dhera të tjera. Bastisje e rrënime pësoi ndërkaq edhe teqeja e Zallit, por falë dhembshurisë që treguan myhibanë e dashamirës të tarikatis, disa vite më pas, teqeja u riçel dhe u ringrit hap pas hapi, duke u shndërruar edhe në vatër diturie bektashiane. Falë njohurive të thella të baballarëve në të fshehtat e tarikatis, çdo ditë në portën e teqesë do të trokisnin dashamirës të rinj.

Kështu, për të ardhur në fund të shekullit të 19-të, atëherë kur në Ballkanin e trazuar po zgjoheshin nacionalizmat dhe identitetet kombëtare dhe fetare. Këto erëra do të vinin edhe në trojet shqiptare, sidomos përmes fjalëve dhe veprave të dervishëve dhe baballarëve, të cilët e patën kuptuar dhe provuar në supet e tyre, zgjedhën otomane. Teqeja e Zallit, me diturinë dhe shqiptarizmin që kishte edukuar për vite me radhë, do të vihej padyshim në shënjestër të Portës së Lartë dhe sipas dokumenteve arkivorë, vetëm katër muaj pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të tre baballarët e Gjirokastrës, baba Ali Gega, baba Zenel Gjoksi dhe baba Zeneli, do të arrestoheshin e mbaheshin në burgun e Janinës. Ata do të liroheshin kohë më pas, prej përpjekjeve të pashallarëve shqiptarë që shërbenin në perandorinë otomane. Ndërsa në agim të shekullit të 20-të, atëherë kur lëvizja autonomiste shqiptare po forcohej dita ditës, teqeja e Zallit do të vihej jo thjeshtë në ballë të teqeve të Gjirokastrës për misionin e saj kombëtarë, por do të bëhej inter-

prete e idealeve të lirisë e pavarësisë, nga Vlora në Manastir, nga Dibra, në Janinë. Tanimë teqeja nuk ishte vetëm vendi ku mësohej të shkruhej e lexohej në gjuhën amtare.

Në odat e fshehta të saj, çetat kryengritëse merrnin prush nga prushi i nacionalizmës shqiptare, duke përçuar idenë e madhe:

Me pushkë e penë, për mëmëdhenë!

Në mënyrë të veçantë, Bajo Topulli, Çerçiz Topulli, Hito Lekdushi dhe udhëheqës të shquar të këtyre çetave, morën në vatrën e ngrohtë të kësaj teqeje, bekimin e baballarëve për të luftuar ndaj sundimit otoman. Kjo vatër e bekuar e mësimëve dhe filozofisë vëllazërore të Haxhi Bektashit, kaloi edhe represionet e andartëve grekë, të cilët u vunë zjarrin themeleve të teqesë. Por sërish, edhe në këto vite barbarie, shkëlqeu optimizmi dhe filozofia e klerit bektashian. Njeri prej momenteve të vështirë që kalonte besimi ynë në këto kohë, përshkruhet aq bukur nga baba Rexhebi, myhib dhe dervish i rrallë i kësaj teqeje, në veprën e tij: "Misticizma





Islame dhe bektashizmi". Ai rrëfen se kur Naim Xhangua donte të falej në xhami, ushtarët grekë qëllonin me gurë të gjithë ata që kalonin para objektit të kultit. Paskëtaj ai shkoi tek baba Selimi dhe i tregoi çfarë i kishte ndodhur. Ky iu përgjigj: "Prandaj duhet të keni besim dhe bindje të plotë në fjalën e Profetit Muhamed, i cili ka thënë: Dashuria e Atdheut lidhet ngushtë me besimin. Kjo fjalë zbatohet pikërisht në këto ditë, pse ne, që nuk e kemi Atdheun të lirë, se kryejmë dot detyrën fetare, që t'i lutemi Zotit. Kjo duhet të jetë një provë të na bindë se pa Atdhe, s'mund të mbahet feja. Ato janë të lidhur ngushtë me njëra-tjetrën."

Teqeja e Zallit ndërkaq po fitonte popullaritet në krejt Shqipërinë dhe ishin dervishët e baballarët e saj Haxhi Jahja Babai, baba Selim Ruhui, dervish Selfo Rashua, dervish Rexheb Beqiraj etj, të cilët morën pjesë aktive në tri kongreset bektashianë, të Prishtës, Gjirokastrës dhe Korçës, duke mëvetësuar bektashizmin prej dogmave të bidateve të Turqisë dhe duke e bërë atë një tarikat kur-

doherë në shërbim të Islamit dhe të kombit. Tejpamësia e këtyre dervishëve dhe baballarëve u vërtetua edhe në vitet e vështirë të Luftës së Dytë Botërore, vite kur teqeja e Zallit u përpoq të ruante sa më të pastra ndjenjat dhe veprimet kombëtare.

Si çdo teqe, kishë apo xhami, teqeja e Zallit, pati një periudhë sprove të rëndë, e cila lidhet me periudhën e ndalimit të fesë në vendin tonë. Por bektashinjtë e Gjirokastrës, sikundër të gjithë Shqipërisë, e ruajtën besimin në shpirt, të bindur se ai nuk do të vononte të ringrihej sërish. Ka qenë shembulli i vyer i baba Haxhi Saliajt, i cili, në fillim të viteve 90-të, të shekullit që lamë pas, me porosi të dede Reshat Bardhit erdhi në këtë teqe, duke nisur gjithçka nga e para. Ndonëse i shkuar në moshë dhe me një barrë historish të trishta, ai mundi të përcjellë historinë e tarikatis në brezin më të vështirë, në atë brez që kishte mësuar në shkollë se si të fyheshin klerikët. Por ishte pikërisht dashuria e besimtarëve të shumtë, ishte bujaria e përhershme e myhibanëve të Lazaratit, ajo që

e gjallëroi teqenë dhe e zbukuroi atë, deri në ditët e sotme. Nuk ka dyshim se krahas kontributit të baba Ibrahim Kukës, baba Hodo Hatikës, baba Abedin Agajt, dervish Esat Rakipit, dervish Lutfi Muços, dervish Shahin Asimit, baba Dervish Canometajt, dervish Hysen Gjinit, dervish Muhamet Këndellaj, dervish Shazivar Mickaj etj, Selia jonë e Shenjtë ka ndjekur me respektin e thellë edhe veprimtarinë e palodhur të baba Sadik Ibros, baba Abdul Shehajt dhe deri tek postmbajtësi i sotëm i kësaj teqeje, baba Skënder Dervishi. Nga krijuesi i teqesë, baba Muhamet Asimi dhe deri tek baba Skënderi, historia 240 vjeçare e këtij vendi të bekuar ka vendin e saj të merituar në krejt historikun e bektashizmit botërorë.

Të nderuar! Ne askurrë nuk e kemi parë historinë e teqeve bektashiane si qëllim më vete. Sepse ne askurrë nuk e kemi ndarë frymën e shenjtë nga atdheu, kombi, familja. Ne jemi përpjekur dhe përpiqemi ende sot, se duke ecur në gjurmë të myrshidëve tanë, të jemi sa më pranë besimtarëve, në të mirat, por dhe në fatkeqësitë e tyre. Veçanërisht sot, në këto ditë të vështira që kalojmë, jemi pranë jush, duke u ngjallur shpresën, duke luftuar meritë dhe pesimizmin. Ne sot, së bashku me lutjet tona, ju bëjmë thirrje sidomos brezit të ri, të mendojnë më thellë, më me shpirt, më me durim për Shqipërinë. Vetëm ne, shqiptarët, do të mund ta bëjmë Shqipërinë! Zoti ju bekoftë të gjithëve! Amin!”

Më pas e mori fjalën znj. Lindita Rova, Kryetare e Këshillit të Qarkut të Gjirokastrës. Ajo uroi Kryegjyshin, klerikët dhe gjithë pjesëmarrësit për këtë ditë përkujtimi i 240 të themelimit të teqesë së Zallit, e cila solli në vemendjen tonë historinë e lavdishme të saj. Kjo teqe ka patur gjithmonë derën e hapur dhe

bujare për gjithë shqiptarët si në rilindjen kombëtare dhe gjatë luftrave botërore deri më sot. Me këtë rast uroj gjithë të mirat dhe vazhdimësinë e traditës për atdhetarizmin dhe dashurinë ndaj Zotit. Ne do të jemi pranë jush dhe komunitetit tuaj në Gjirokastrë. Përshëndeti në emrin e gjyshit të së Gjirokastrës gjithashtu drejtuesi i teqesë së Zallit baba Skënderi, i cili u shpreh me emocion: “Në këtë ditë të shënuar, jam krenar që i takoj brezit më të ri në traditën e gjithë klerikëve që kanë drejtuar këtë teqe të mrekullueshme nga themelimi i saj e deri më sot. Kjo ditë është ditë e mesazhit që kanë dhënë klerikët e ndritur të teqesë së Zallit, na takon ne ta çojmë më tej misionin e vyer dhe të ndritur të Haxhi Bektash Velit”.

Më pas sheh Bujar Horasani i tarikatit kadri të Shqipërisë përcolli urimet më të mira dhe për një bashkëpunim të vazhdueshëm me Kryegjyshit Botërore Bektashiane. Në këtë ditë kujtoj edhe rilindjen e bektashizmit në vitin 1991, kur kam qënë pranë Dede Reshatit, një misionar i madh dhe kam kujtimet më të mira për këtë shenjtë. Rugën e tij po e vazhdon Kryegjyshi i sotëm Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Më vjen mirë që baballarët e dervishët janë bashkë në këtë ditë të paharruar për historinë e bektashizmit. Ne jemi vëllezër dhe do të vazhdojmë të bashkëpunojmë si vëllezër. Paçi gjithë të mirat, mirësi dhe dashuri tha ai. Ndërsa, kryetari i bashkisë të qytetit të Gjirokastrës z. Flamur Bino midis të tjerave tha: “ E gëzofshi këtë ditë, fjalën e Perëndisë ua gëzon të gjithëve në këtë 240 vjetor, sikurse dëgjuam fjalën e baba Mondit që solli historinë e teqesë së Zallit, ku theksoi se çfarë përfaqëson bektashizmi si tarikat për atdhetarizmin, familjen dhe fenë. Ne mësojmë nga mesazhet që kanë

dhënë klerikët bektashian në historinë e madhe të kësaj teqeje të njohur në çdo periudhë historike të vendit tonë. Si përfaqësues i pushtetit lokal kemi detyrimin të ndihmojmë për t'i sjellë më afër si objekte kulti të rendësishëm për turizmin dhe qendra komunitare për vëllezërit dhe motrat pa dallim feje. Paçi urimet më të mira në këtë ditë të shënuar”. Më pas Kryegjyshi i prezantoi me këtë rast “Ekspozitën fotografike” e përgatitur enkas për këtë përvjetor nga grupi i muzeut të bektashizmit, z. Enver Kushi dhe Sotirulla Hoxha, të pranishmit u njohën me 24 stendat për historinë e bektashizmit në Gjirokastrë. Në stendat jepen misionarët e parë që u dërguan në Shqipëri, më i hershmi erdhi Sari Salltiku në Krujë dhe Shqipëri, Ballkan. Më pas erdhen Baba Ali Horasani në Krujë; Dylgjer Hysejni, baba Aliu në Elbasan, në Berat, Skrapar, Kolonjë, Përmet, Vlorë etj. Këtë fakt e vë në dukje edhe Evlia Çelebiu për teqet e para në Vlorë, Gjirokastrë, Pogradec dhe shumë të tjerë. Që të gjithë këta shkuan në Shqipëri ndërmjet shekullit XIV-të dhe XV-të. Këta misionarë punuan pa rreshtur për të hedhur themelet e bektashizmit në Shqipëri, si edhe në vende të tjera. Gjirokastra njohu misionarin e parë baba Arshiu në shekullin e XVI-të, me origjinë nga Anatolia i cili ndërroi jetë më 1621. Tyrbja e tij ndodhet në lagjen Cfkë. Më pas njëra pas tjetrës u ngrit teqeja e Asim babai, Shtufit dhe e Mesit, Gjirokastra ka patur tre teqe të famshme me histori të madhe.

Një bisedë midis vëllezërish vijoi më pas edhe një koktej e shtruar me këtë rast, ku vendin e hallevë të sotme e zunë tregimet e mrekullueshme për dervish e baballarë që mbajtën në këtë teqe të pafikur dritën e besimit.





BESIMI NË ZOT, NA MBAN TË LIRË!

**Kryegjyshi Botëror Bektashian,
Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj,
merr pjesë në Mëngjesin e Lutjeve në SHBA**

Me ftesë të Departamentit Amerikan të Shtetit, në muajin shkurt të këtij viti, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, së bashku me lider fetarë nga e gjithë bota, mori pjesë në veprimtarinë e përvitshme të Lutjeve të Mëngjesit, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Eventu në fjalë ka synuar kurdoherë të arrijë në një bilanc të mundshëm të lëvizjeve dhe perceptimeve fetare globale, duke evidentuar një varg problemesh madhore dhe duke diskutuar në kontekstet e universalizmit të besimit tek Krijuesi, si një e drejtë për cilindo, për çdo komb, etni, ngjyrë apo pakicë njerëzore. Sigurisht ky mëngjes Lutjesh, ka qenë dhe mbetet një ballafaqim i çiltër dhe i hapur idesh, brenda të cilit lider fetarë dhe shtetëror priren në zgjidhjen e vështirësive, duke i rikthyer aspekteve dhe dobive që mbështesin dhe përparojnë besimin.



Ne, të gjithë këtu, vijoi Presidenti Trump, jemi të bashkuar në bindjen tonë. Ne e dimë se kombi ynë është më i fortë, e ardhmja jonë është më e ndritshme dhe gëzimi ynë është më i madh, kur i drejtohem Zotit edhe kur kërkojmë prej Tij të mbushë jetët tona me mëshirën e pafund. Në gjithçka që po bëjmë, ne po krijojmë një kulturë që mbron lirinë, e cila përfshinë edhe lirinë fetare.



u mbajt dhe u lartësua nga besimi, lutjet dhe përkushtimi i besimtarëve fetarë. Për të mbrojtur bashkësitë e besimit ne kemi ndërmarrë veprime historike, përfshi të drejtën kushtetuese për t'u lutur në shkollat publike...

Dje, administrata jonë promovoi për të parën herë Aleancën Ndërkombëtare të Lirisë Fetare, e para e këtij lloji në ndihmë të lirive fetare. Është vërtetë diçka madhështore. Më tepër se 25 vende janë bashkuar tashmë në fushatën tonë. Dua të falën-

Në mënyrë të veçantë, në Lutjen e Mëngjesit të datës 6 shkurt, të pranishmit kanë ndjekur me interes të veçantë, fjalën e Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, i cili me shembuj konkret, solli në vëmendjen e të gjithëve se kombi amerikan, po ecën dhe përparon dita-ditës, duke qenë i bashkuar në lirinë e besimit, duke qenë i bekuar të jetoj në paqe dhe mirënjohës për kontributin e çdo feje. Ne, të gjithë këtu, vijoi Presidenti Trump, jemi të bashkuar në bindjen tonë. Ne e dimë se kombi ynë është më i fortë, e ardhmja jonë është më e ndritshme dhe gëzimi ynë është më i madh, kur i drejtohem Zotit edhe kur kërkojmë prej Tij të mbushë jetët tona me mëshirën e pafund. Në gjithçka që po bëjmë, ne po krijojmë një kulturë që mbron lirinë, e cila përfshinë edhe lirinë fetare. Siç kam thënë këto ditë, ne nuk ndëshkojmë lutjen. Ne nuk heqim kryqet. Ne nuk bashkojmë simbole besimi. Në Amerikë, ne ngremë lart besimin. Ne ushqejmë fenë. Ne ngremë zërin tonë në lutje dhe shikimi ynë është kurdo-



herë lart, drejt lavdisë së Perëndisë. Zoti është kurdoherë brenda nesh. Përpara se të ngrihej një qiell-gërvishtëse në New York City, mijëra familje të varfra amerikane dhuruan gjithçka mundën për të ndërtuar katedralen e mrekullueshme të Shën Patrikut. Kur Buzz Aldrin zbarkoi në hënë, ai tha: Houston, unë do të doja të kërkoja disa minuta heshtje! Pastaj lexoi disa vargje nga Bibla. Në çdo fazë, marshimi i gjatë i kombit tonë për të drejtat civile, u frymëzua,

deroj Sekretarin e Shtetit Mike Pompeo së bashku me Ambasadorin Sam Brounback, të pranishëm në këtë auditor, për udhëheqjen e kësaj nisme historike. Faleminderit shumë, të dyve. Të gjithë ne sot këtu, rikonfirmojmë këto të vërteta të përjetshme. Besimi në Zot na mbanë të lirë, lutja na bën të fortë.... Ne po rivendosim shpresën dhe po ripërhapim besimin. Ne po ndihmojmë qytetarët e çdo prejardhje, të marrin pjesë në rindërtimin e madh të kombit

tonë. Ne e dimë tanimë se Amerika do të shkëlqejë gjithmonë si një tokë lirie për të gjithë kombet e botës. Për këtë mëngjes, le të kërkojmë nga Ati në qiell të udhëzojë hapat tanë, të mbrojë fëmijët tanë dhe të bekoj familjet tona!

Një pritje të veçantë, Kryegjyshit Botëror Bektashian, i rezervoi pas Mëngjesit të Lutjeve, edhe Kongresmeni i SHBA-së, Michael T. McCaul, i cili që në krye të herës e falënderoi Kryegjyshin që me qëndrimet e tij, u është bashkuar kurdoherë nismave të paqes dhe lirive të besimit fetar, duke dhënë kontribut të çmuar, në këtë rrafsh. Ai shtoi mes të tjerave se ishte thjeshtë jo vetëm në dijeni, por edhe i kënaqur për perceptimet e Selisë së Shenjtë Bektashiane, për sa i përket angazhimeve për paqe, si dhe të veprimtarisë konkrete të komuniteteve bektashianë të kudondodhur në botë, në respektimin e të drejtave themelore të ushtrimit të lirive fetare. Mbrojtja e këtyre lirive, zgjerimi i hapësirave të mundshme ndër religjioze, si dhe përballimi i sfidave të ardhme, sigurisht do të jenë sprova për përgjegjësitë e Selisë suaj. Nga ana e tij, Kryegjyshi Botëror Bektashian, Haxhi Dede EdmondBrahimaj, e njohu kongresmenin amerikan shkurtimisht me historikun e lindjes dhe zhvillimit të bektashizmit në Ballkan e më gjerë, duke u ndalur paskëtaç në tiparet kombëtare të këtij besimi në Shqipëri. Pavarësisht goditjeve të ndryshme që bektashizmi ka marrë, sidomos në shekujt e 19 dhe 20, ky tarikat jo vetëm që nuk e humbi fizionominë dhe filozofinë e tij, por mundi të ruaj vlerat më të mira të tij, për t'i trashëguar dhe përcjellë sidomos në këto dekada të mileniumit të ri. Ne jemi krenarë, përfundoi midis të tjerash Kryegjyshi Botëror Bektashian që ecim në ato gjurmë të kthjellëta të atyre dervishëve dhe baballarëve bektashianë, të cilët i panë fatet e kombit të tyre të lidhur ngushtë me besimin dhe me devocionin e tyre ndaj Krijuesit, e bënë bektashizmin të njohur dhe të dashur në shumë kontinente.

Ndërkaq, në Departamentin Amerikan të Shtetit, Kryegjyshi Botëror u prit midis të tjerëve, edhe nga këshilltarja e politikave dhe nismave strategjike për çështjet e lirisë së besimit, zj. MariyamCeventvala, e cila së pari falënderoi Kryegjyshin për bisedën e ngrohtë dhe frytdhënëse të zhvilluar pak muaj më parë në Tiranë. Më tej, ajo vijoi me nismën e marrë prej DASH në kuadrin e lirive fetare dhe duke qenë në dijeni të harmonisë së feve dhe besimeve në Shqipëri, çmoi rolin e Selisë së Shenjtë në këtë drejtim. Së fundmi, zj. Ceventvala u shpreh se jo vetëm në

Selinë e Shenjtë në Tiranë, por kudo në komunitetet e besimtarëve bektashianë, çështjet e besimit janë parë kurdoherë brenda lirive universale njerëzore, brenda konventave ndërkombëtare, duke dëshmuar tolerancë dhe mendim bashkëkohor.

Ndërsa Kryegjyshi Botëror Bektashian, në vijim të fjalës së tij, ceku sidomos bashkërendimin e pikëpamjeve për të ngritur më lart përgjegjësitë historike të Selisë së Shenjtë Bektashiane, sepse kjo do t'i shërbejë jo thjeshtë këtij tarikati, por edhe frymës vëllazërore që ai shpërndanë ën çdo komunitet. Një njohje zyrtare më e plotë dhe një qasje juridike më e lartë, do të mund të ndikonte që Qendra Botërore Bektashiane, të luante sa më të plotë rolin e saj. Në këtë kontekst, ne do të mirëpresim çdo ide apo ndihmë konkrete prej DASH, me të cilin, marrëdhëniet sa vjen e bëhen më të ngushta, të bindur se kjo nxitje do të ndikojë në fuqizimin e rolit dhe kontributit bektashian.

Gjithashtu, në fund të bisedës, Kryegjyshi Botëror Bektashian, vuri theksin tek ushtrimi i lirive universale



dhe atyre fetare, për t'u ndalur në problemin e uzurpimit të teqesë bektashiane të "Harabati-Babës" në Maqedoninë Veriore. Një grup njerëzish të pandërgjegjshëm, tha ai, të shtyrë nga segmente të inkriminuar të shoqërisë së sotme, jo vetëm që kërcënojnë ushtrimin e lirive fetare brenda një objekti historik 500 vjeçar bektashian, por kërcënojnë fizikisht jetët tona, prej 10-12 vitesh.

Nisur nga parimet bektashianë të urtësisë dhe mirësisë, ne u jemi drejtuar kurdoherë me gjuhën e arsyes dhe të fesë, këtyre femohuesve, duke dashur që mos ta humbasim për asnjë rast vlerën e pallogaritshme të këtij objekti shekullor të kultit. Por përkundër qëndrimit tonë të urtë fetar, uzurpuesit vazhdojnë sot e kësaj dite me kërcënimet fizike. E patolerueshme mbetet ndërkaq edhe sjellja e qeverisë së Maqedonisë Veriore, e cila, ndonëse ka në tryezën e saj vendimin e Gjykatës së Strasburgut për largimin e uzurpatorëve nga teqeja, nuk ndërmerr asnjë veprim konkret për të zbatuar detyrimet dhe për të respektuar liritë themelore fetare. Sidoqoftë, ne do të vazhdojmë përpjekjet tona deri në fund, kurdoherë brenda frymës sonë fetare dhe ligjeve demokratike në fuqi.

Gjatë ditëve të qëndrimit në SHBA, Kryegjyshi Botëror Bektashian, zhvilloi takime me lider të ndryshëm fetarë. Ndërsa në New Jersey ai u prit nga një komunitet biznesmenësh shqiptarë, të cilët u interesuan për investime në komunitetin bektashian.

Kores. "Urtësia"



Nder për kle



Në 9 shkurtin e këtij viti, në mjediset e Pallatit Papal të Ananjit, Këshilli Drejtues i Komitetit Shkencor dhe Senati Akademik, patën të ftuar në mesin e tyre, Kryegjyshin Botëror Bektashian, Hirësinë e Tij, Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Prania e profesorëve, studentëve Akademisë dhe veçanërisht e Presidentit të Nderit, Eminencës së Tij, Kardinal Jose Salavia Martins e bën akoma më të shenjtë këtë pasdite, të cilën Kryegjyshi Botëror e shfrytëzoi për të dhënë një imazh sa më të qartë të gjendjes në të cilën ndodhet bektashizmi i sotëm, në më shumë se 30 vende të botës. Ai shpjegoi midis të tjerave se roli i këtij tarikati brenda zhvillimeve fetare në Shqipëri e Ballkan është jo thjesht i denjë, por shumë bashkues, duke ngritur kurdoherë ura paqeje e bashkëpunimi midis feve dhe besimeve të ndryshëm, si edhe duke qenë në radhët e para të mbrojtjes dhe çuarjes më tej të trashëgimisë së Islamit. Më pas, ka qenë Kryetari i Komitetit Shkencor të Akademisë, Eminenca e Tij Imzot Enrico dal Covolo, i cili përpara se të dorëzonte titullin e lartë, ka folur për Selinë e Shenjtë Bektashiane. Ky kontribut, vijoi Imzot Kovolo, konsiston si në ruajtjen e identitetit

// Kryegjyshi Botëror Bektashian, Hirësia e Tij, Haxhi Dede EdmondBrahimajmer titullin e lartë “Për një kulturë paqeje” të akorduar nga Akademia Bonifaciana //

Merikët bektashianë!



fetar tëbektashizmit, ashtu edhe në pasurimin e këtij identiteti me prurje të reja, në kontekstet që kalojmë, duke u mbështetur kurdoherë në dashurinë ndaj Zotit.

Ai theksoi gjithashtu se Qendra e Sotme Botërore e bektashizmit në Tiranë, ka mundur tëidentifikohet me shfaqjet më të pastra të Islamit, larg çdo klime konfrontimi apo radikalizmi. Në fund ai tha se këshilli shkencor dhe Senati Akademik, me dekret nr. 74/20, datë9 shkurt 2020, kanëenderin t`i akordojnë Hirësisë së Tij, Dede EdmondBrahimaj, Kryegjyshit Botëror Bektashian çmimin ndërkombëtar“BonifacionVIII”“Për një kulturë paqeje” dhe titullin e nderit të senatorit Akademik me motivacion: “Për angazhimin dhe kontributin aktiv, kulturor dhe shoqëror, për realizimin e nismave, synimeve dhe vlerave sipas ideve të ndjekura nga Akademia Bonifaciana.”

Në përshëndetjen e tij, Kryegjyshi Botëror Bektashian, falënderoi për nderin e madh, të presidentit, senator dhe intelektualë të shquar të Akademisë në fjalë, të cilët me eventin e organizuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë

kanë respektuar udhëtimin e gjatë, tetë shekullor të tarikatit, ku veçmiliona besimtarëve, mbetet padyshim i shquar kontributi imijëra dervishëve dhe baballarëve anekënd botës. Ai vijoi duke thënë se një nder tëtillë, është ndërkaq edhe fryt i mbijetesës së klerikëve bektashianë, përballë konteksteve të ndryshëm fetarë, në të cilët u dëshmuar jo thjeshtë devocioni i thellë ndaj Krijuesit, por edhe ndaj fateve të atdheut dhe kombit. Në fund, Kryegjyshi u shpreh: “Ju siguroj të nderuar të pranishëm, se ky çmim ndërkombëtar, pavarësisht se më jepet mua personalisht, shkon sot për gjithë vëllezërit e mi klerikë bektashianë. Ndërkaq ky çmim do të përbëjë një program me vizion më të plotë, në veprimtaritë e shumta të Selisë së Shenjtë Bektashiane, si në rrafshin doktrinar të saj, ashtu edhe në veprimtaritë e shumta me karakter fetar, shkencor apo shoqërorë. Njëherazi nderimi i sotëm, do të na shërbejë për t`u përballur me sukses ndaj sfidave të sotme tëcivilizimeve.

Koresp. "Urtësia"

// Në teqenë e baba Rexhebit, në Detroit, mbledhet kuvendi vjetor i "Vatrës" për shtetin e Michiganit. //



Kuvendi i dashurisë

Vatra zgjodhi këtë herë faltoret e Zotit, teqenë dhe kishën për të organizuar kuvendin zgjedhor, ashtu siç kanë bërë dekada më parë, burrat e shquar Faik Konica dhe Fan Noli me miq të tyre. Organizimi i seancës plenare në mjediset e teqesë së baba Rexhebit dhe darka përmbyllëse e shoqëruar me përshëndetjet e rastit në kishën "Zoja Pajtores" bartnin brenda tyre modelin e mrekullueshëm të harmonisë fetare, të këtij veprimi kaq të zgjuar e atdhetar të trashëguar në breza. Përveç organizatorëve të këtij eventi, fal-

enderimet u shkojnë edhe prijësve fetarë, dervish Eliton Pashait dhe famullarit Dom Ndue Gjergji së bashku me këshillat e tyre respektive sepse iu rikthyen një tradite që Vatra e ka pasur në substancën e vet në udhëtimin më shumë se një shekullor. Por urimi u shkon ndërkaq edhe vatanëve veteran të Michiganit, që trokitën në dyert e këtyre tempujve, me po atë dashuri, me po atë preokupacion, me po ato shpresa të mëdha për Shqipërinë, e cila të jetë e bukur, e lirë, e paprekur.

Këtu, pranë shenjtërisë dhe filozofisë mistike të

baba Rexhebit, në teqenë bektashi-ane, çuditërisht ndihesh më i përmbajtur, më afër Zotit, më i ndjeshëm dhe në vend të urrejtjes, nga zemra buron respekti dhe dashuria ndaj njeri-tjetrit, urtësia dhe maturia për gjithçka që flet në faltore. Ndërkaq, duke qëndruar pranë portreteve të baballarëve të ndritur, por edhe Ismail Qemalit, Dedë Gjon Lutit, Naim Frashërit etj, ndihesh krenar për historinë e kombit tënd dhe bëhesh më i vëmendshëm ndaj rrjedhave të ditëve të sotme. Më mirë se kushdo, në këtë ditë historike, është Julian Çefa, ky veteran i Vatrës, i cili ndjen mirësinë e trashëguar, ndërsa thotë: “I lumtur është ai që respekton atdheun dhe kombin. Jeta është shumë e shkurtër. Më kujtohet kur u bëra vatrën, 52 vite më parë, por që më duket se ka ndodhë dje. Më 1968 mora pjesë në kremtimin e pavarësisë të Shqipërisë që organizonte dega e Vatrës e Michiganit. Aty njoha njerëz që kishin ardhur herët nga Shqipëria, edhe përpara lufte. Një vit më vonë, në nëntorin e vitit 1969, mora pjesë në 60 vjetorin e gazetës “Dielli” dhe në seminarin ndërkombëtar të Vatrës. Ishte festë e madhe që mblidhte shqiptarë nga pesë kontnente, madje edhe nga Afrika. Ishin aty edhe një grup vajzash arbëreshe që e hijeshuan festën me veshjet e tyre arbërore. Aty njoha Antoni Athanas, Peter Çi, Hamdi Uruçin. Aty njoha dy kolosët e letërsisë shqipe Ernest Koliqin dhe Martin Camaj, të cilët i pata edhe mysafirë në shtëpinë time.”

Më tej vatrënë të tjerë, sollën në vëmendje veprimtaritë më në zë të Vatrës, përmes të cilave është mbajtur i ndezur prushi i atdhe-



tarisë tek bijtë e shqipes. Kuvendit në fjalë, i dha prirjen e dashurisë dhe vëllazërisë edhe dervish Eliton Pashai, i cili solli frymën filozofike dhe urtësinë e baba Rexhebit, këtij vatrani shembullor. Ai nënvizoi edhe një herë, idenë se teqeja, kisha apo xhamia në Michigan, kanë luajtur pa dyshim rolin e madh të tyre në mbajtjen gjallë të traditave kombëtare. Këto objekte kulti, përfundoi ai, jo vetëm që kanë afruar ndjekësit e tyre në devocionin ndaj Krijuesit, por kanë ditur kurdoherë të çlirojnë atome energjie dhe dashurie për kombin shqiptar. Vatrënë në çdo rast, edhe kur kanë patur ndonjë keqkuptim midis tyre, u janë drejtuar këtyre objekteve me zemër në dorë dhe

kanë dalë prej dyerve të tyre më të bashkuar me sho-shoqin. Ndërsa në darkën e shtruar me këtë rast, famulltari Dom ndue Gjergji, midis të tjerave ka uruar Vatrën dhe vatrënë që t'i rikthehen herë pas here burimit të kristaltë, aty ku ka nisur udhëtimin e vet, ky mision me dimension kaq kombëtar. Ta ruajmë dashurinë për Zotin dhe për kombin. Por edhe ta përcjellim këtë dashuri, tek brezat e sotëm, tek brezat e nesërm. Sepse sado të fortë të jemi ekonomikisht, sado të sigurt t'i kemi familjet tona, serish vatra do na vijë në ndihmë, qoftë edhe duke na kujtuar se ku i kemi rrënjët. Respekt për vatrënë, të djeshmit, të sotmit, ata që do vijnë.

Koresp. “Urtësia”



Poezi

Poezi nga Myqyr Zyka

Thuaja ti këngës!

Ashtu, bilbil,
Këndo si qëmotit,
Këngët për Aliun,
Për trimin e Zotit.

Bëj të vetmen punë
Që di të bësh ti,
Thuaja, more, shtruar
Për Imamin Ali!

Thuaja, t'i këngës,
Thuaja me lotë,
Mbretit të evlijave,
Mbret në dy botë.

Thuaja pa pushuar,
Thuaja me të qarë,
Veç shpatës së tij
I thonë "zylfiqar".

Sua i këngëtarëve
Ngrije më lart zënë,
Luan i Allahut
Për atë është thënë.

Thuaja, ti, këngës
Anës së bahçesë,
Është këng'e këngëve
Burr'i Fatimesë.

Dije mire, or mik,
Zvendës i Pejamberit,
Me "dorë" të tij hap
Portën e Hajberit.

Ti këndosh Aliut
O, t'i zog i bukur,
Nuk është një punë
Thjesht për t'u dukur.

Ta dish, te Aliu,
Kryeshenjtëria,
Më e bukura këngë
Janë dijet e Tija.

Baba'i Hasanit
Dhe imam Hysenit,
Si një i padukshëm
I jep rrugë dervenit.

Dervenit të Hakut
Tharm'i shenjtërisë,
Të Mirët, si te nëna,
Të gjithë pinë sisë.

Me qumësht evlihave
Ushqehen me hashk,
Ku gjithë të dyzetët
Në një janë bashkë.

Gjak i gjithësecilit
Rrjedh tek të gjithë,
Ashtu si një këngë
Degëve të selvisë.

Ndaj, thuaja bilbil
Siç bën' dhe kumrija,
Kurrë mos e ndaloni
Këngën te selvia!

Një lule behari
Çeli plot bukuri,
Më deh me aroma
Ja, Imami Ali!

Bilbili gjyzar
la thotë në kuvli,
Magjepsem nga zëri
Ja, Imami Ali!

Si flutur krahëshkruar
Vjen një hajmali,
Më qëndron në zemër
Ja, Imami Ali!

Më vjen një ëndërr
Në një natë me shi,
Dija është një pikë
Ja, Imami Ali!

Seç po më djeg hashku
Për atë dashuri,
Në Rrugë të Hakut
Ja, Imami Ali!

Fjalë mendjelehti
Më the duke lozur,
Këngët për Aliun
Bilbil s'kanë të sosur!

Diell midis tyre

Bilbil a s'më thua
Pse kënga s'të vjen,
Kur të them "thuaja"
Këngës për Hysen?!

E nëse, ti, or mik
Nuk ia thua dot,
Atëhere qajë,
dhe mbytu në lotë!

Se gjithë të Mirëve
Ti u solle gjëmën,
Dhe, moj, zemërgur
More veç nëmën!

Ndaj le ta dëgjojë
Kush bën të këqija,
Si vetë kjo tokë
Do ta mbulojë zija.

Ehli-Bejti

Për vlerën e rrallë
Dy fjalë do themi;
Se është diamant,
S'është gur mademi.

Hytbe_lamtumira
Është vakt që hani,
Kuran-Ehli Bejtin
Kurrë mos i ndani!

Aliu-Fatimeja
Janë Ehli Bejti,
Hasani-Hyseni
Edhe Muhameti.

Janë të një soji,
Siç është Kurani,
Dhe vet amaneti;
Kurrë mos i ndani!

Kështu tha Profeti
Fjalë, një histori,
Kur Zoti e thirri
Të shkonte pranë Tij.

Për Ehli-Bejtin,
O usta i këngës,
S'ndejnë të lodhur
Gjithë dejet e zemrës.

Ndaj, ashtu, si ti
Fushës me trëndelinë,
Eh, sa janë dehur
Nga ai burim.

Nur Haxhi Bektash!

Tani, bilbil xhani,
Me një zë të butë,
Këngës do t'ia thuash
Për Plakun e urtë.

Për Haxhi Bektashin,
Për Kutbin e Madh ,
Një këngë nga të tuat,
Një tjetër avaz...

Se unë tek ai,
Si shumë të tjerë,
Dorën në degë hodha,
Mbahem të mos bjerë!

Si një mërgimtar
Këtë botë e lashë,
I dehur prej Hashkut
Nur, Haxhi Bektash!

Dhe myrshidit tim
Dy-tri fjalë i thash,
Atje në mejdan
Nur, Haxhi Bektash!

Shkova që pa vdekur
Këtë jetë e lashë,
Se më thirri Piri,
Nur, Haxhi Bektash!

Në sofrën e t'Mirëve
Ku besën e dhashë,
Kërkoj të bëjë vend
Nur, Haxhi Bektash!

Gjithë botët brodha,
Sa ndër gjunjë rashë,
Para një çiraku
Nur, Haxhi Bektash.

S'di të them, bilbil,
Që këngë thur e thur,
Po kjo vallë pse ngjiti
Ilaç për të sëmurë?

Se, ti veç një gjë di,
Të njëjtin avaz,
Por atë s'ta pranon
Dëshmor' i Qerbelasë.

Se koha, i dashur
Ka natën e saj,
Ndaj le t'ia nisim
Që të dy me vajë.

"Imam" vetë e thëna
Të vuri në pritë,
O mjekërpërgjakur,
Hyseni Shehid.

Pesëmbëdhjetë mij'engjëj
Kryejnë ritin e zis,
Për ty lotojnë qiejt
Ja, Hyseni Shehid!

Rini e parajsës
Ty të ka për prijës,
O Zemër e Profetit
Ja, Hyseni Shehid!

Shandanin e qiellit
Yjet bëjnë dritë,
Diell midis tyre tyre
Hyseni Shehid!

Zoti të ma bëj fat
Ta takoj një ditë,
Si i bindur i Tij
Hyseni Shehid!

Ata shtatë qiej
Në një pikë loti,
Sus do të rrinë
Kur të flasë Zoti.

Gjyqi i së vërtetës
Ty të është bërë,
Nga shehidët e larë
Me gjak të tërë.

Për ty Qerbela...
"Ah" gjithë botët,
Për atë të ngjarë
S'do t'u reshtin lotët.

Bektashizmi në trevat jugore



Prof. Dr. Bardhosh Gaçe

Në rrjedhën e zhvillimeve kulturore dhe historike ka pasur bashkëpunim dhe një lloj dakordësie të çuditshme të shqiptarëve, pavarësisht besimit që i kanë përkatur. Kjo ka dëshmuar një vijimësi historike të çuditshme, domosdoshmërisht të vështirë të tyre, që ka ndërtuar dhe “qasjen” e bashkëpunimit dhe marrëveshjes me njëri-tjetrin në mënyrën më paqësore dhe më të rëndësishme.

Në këtë pikëpamje dhe rrugëtimi kulturor, historik, etnopsikologjik, pra gjithë struktura jetësore dhe kulturore e komunikimit ndër epoka dhe ndër kultura, të cilat janë shfaqur dhe janë bërë prezente në këtë rrugëtim marrëdhëniesh dhe strukturash social- ekonomike, shqiptarët kanë ditur të kapërcejnë besimin, por duke e respektuar si besimin e vet dhe atë të tjetrit, për të siguruar mbijetesën.

Në këtë rrjedhë të vështirë historike, janë shfaqur luftëtarë, familje të njohura, njerëz të dijes, strategë luftërash, prijës, udhëheqës, njerëz të besimit dhe besime, që për fatin e mirë dhe të çuditshëm janë shndërruar në aleatë të rëndësishëm të mbijetesës së këtij populli të vogël. Në këtë kohë, madje që nga momenti kur ndarja e kishën ndodhi, drejt Ballkanit, Shqipërisë dhe Perëndimit i hodhi sytë Perandoria Osmane, e cila mbështetej nga një autoritet numerik dhe mirë-organizmi fetar si Islami. Përgjatë shek. XV edhe në Shqipëri u shfaqën ekspeditat e para turke. Të kësaj kohe janë dhe shenjat e shfaqjes së një “sekti” fetar, i cili doli nga gjiri i islamizmi, të njohur me emrin bektashinj. Bektashinjtë, në fillimet e veta ishin pjesë e ekspeditave të ushtrisë turke, në grupime të vogla, të cilët eksploronin vende të ndryshme të Ballkanit, në mënyrë të veçantë Shqipërinë.

Bektashizmi, duke qenë brenda besimit islam, një besim i vjetër dhe autoritar në botë, dalëngadalë (pavarësisht se ka shumë interpretime mbi historinë e tyre të mbijetesës dhe

brenda perandorisë dhe besimit të tyre autoritar) krijoi fytyrën e vet, i interpretuar në mënyrë hyjnore nga udhëheqësit e vet shpirtërorë dhe autoriteti i të cilit është Haxhi Bektash Veliu, i lindur në Persi (1249) dhe vdekur në Turqi (1344).

Bektashinjtë u shfaqën si panteistë, me tiparet e humanizmit, liberalë, tolerantë dhe të shquar për vëllazërinë mes njeri-tjetrit. Haxhi Bektashi paraqitet si pasardhës i Abaz Aliut, dhëndrit të Muhametit. Shpejt, ata arritën të dalin nga strukturat e ekspeditave ushtarake dhe fituan statusin shoqëror, të lidhjes së fortë me besimin përmes një marrëdhënie specifike ndryshe të gjithë besimeve të tjera, madje të diferencuar deri diku dhe brenda besimit nga kishin dalë.

Në Shqipëri bektashizmi përkon me zhvillime të mëdha politike, fillimisht në Jug, kur ata u shfaqën për herë të parë rreth viteve 1380- 1385 në Berat dhe Skrapar, pastaj në bregdet, për të marrë përhapje në Shqipërinë e Mesme e deri në Veri, ku sot ka jo pak krahina apo fshatra që janë të lidhur shumë me besimin bektashi. Në rrjedhën e ngjarjeve historike, bektashizmi shqiptar u bë fakt i rëndësishëm politik, kulturor, fetar, historik dhe letrar. Lidhja e fortë me fatet e Shqipërisë, e cila kërcënohej herë pas here dhe reformë pas reforme në Perandori dhe kundërshtarëve rreth saj, të glabërohej, të zhdukej dhe të copëtohej, e bëri më të dukshëm këtë lloj besimi, i cili iu vu në shërbim kauzës kombëtare dhe kulturës së vendit, duke qenë në një llogore me të gjithë klasën përparimtare të vendit, e kujtdo besimi tjetër qoftë që ishte prezent në vend.

Rilindja Kombëtare shqiptare është lidhur fort me bektashizmin. Vëllezërit Frashëri, të cilët milituan kaq shumë për Shqipërinë, në kuptimin më fundamental të fjalës, poetë dhe mendimtarë të tjerë të njohur, të cilët ishin bashkëkohorë në nivelin e dijes, po aq sa kishte nivel dija në Paris, Romë, Vjenë, Londër, Amsterdam, Muniha gjetkë, gjetën inspirim dhe orientuan njerëzit drejt të ardhmes për dije, kulturë dhe Pavarësi. Perënditë dhe njerëzit e vullnetit hyjnor

bektashi i gjeje në Tomor, në Vlorë në Kuzum Baba, Sari Salltik (Krujë), Dibër, në Bulqizë, Përmet, Kolonjë, Shkëlzen, Martanesh, Buzëmadhe (Kukës). Në Kurorën e Malit në Sevaster, Tepelenë, Përmet, Gjirokastër, Smokthinë, në lartësitë e maleve dhe zemrat e njerëzve, të vëna në shërbimin e vendit.

Në këtë hapësirë zhvillimesh, trevat jugore të Vëndit kanë luajtur një rol të rëndësishëm, njëherësh duke qenë një vend me rëndësi strategjike të lakmueshme nga të huajt dhe pushtuesit, por ndërkohë duke qenë dhe një trevë e rëndësishme në të cilën zhvillimet historike, kulturore, politike, të besimit dhe të dijes patën vendin e vet. S'kishte si të ndodhte ndryshe, në Vlorë, Tepelenë, Gjirokastër, Përmet, Kolonjë, Konicë, dhe në të gjithë ndikimin e saj, por edhe në epiqendrat e krahinës më të dëgjuar të Jugut, Labërisë, një krahinë e rëndësishme etnologjike me "Kanunin" e saj, një tregues fundamental historik për një trevë të caktuar, ku bektashizmi ka historinë e vet. Ai është shfaqur herët, që nga Mesjeta, e dëshmuar dhe me teqenë e Sinan Pashës në Kaninë, pastaj me teqenë e madhe dhe me emër të Smokthinës, teqenë e Kuzum Babit, Kurorën e Malit mbi Sevaster, Frashër, Gllavë, Gjirokastër, Shkozë, Kulmak, Prishtë dhe në vende të tjera, të njohura përmes teqeve dhe vendeve të tjera të shenjta.

Dëshmitë mbi urdhrin bektashi në viset jugore të vëndit janë të hershme dhe vijnë nga burime të besuara. Njëri prej tyre është Ismail Qemal Vlora, i cili në kujtimet e tij, të botuara në Londër (1920) na njofton se ky urdhër besimi në Vlorë e Labëri, kishte vepruar që në shekullin XV. Besimi (urdhri) bektashi lidhet fort me një lloj vijimësie historike tradicionale - atdhetare në Shqipëri dhe në Jug të vëndit. Kështu, teqeja e ngritur në Kaninë, e themeluar nga Sinan Pasha, pasardhës i Gjergj Arianitit, (një figurë e njohur historike dhe luftarake), katragjysh i Ismail bej Vlorës, ka qenë një nga qendrat e rëndësishme të kulturës bektashiane, e cila ka disponuar rreth 7200 libra të kulturës botërore, duke luajtur një rol të madh në kulturën dhe edukimin e njerëzve të kësaj krahine dhe më gjërë.

Bektashizmi është një nga kulturat dhe urdhrat e besimit, i cili ka lënë gjurmët veta, të cilat nuk mund të shlyhen lehtë. I demonstruar përmes teqeve, mjedise të besimit, apo dhe në mënyra të tjera të objekteve të kultit të shenjtë, ai dëshmohet në Turan, Krahas, Matohasana, Sevaster, në Smokthinë, në Brataj, në Kuç, në Kaninë, në Drashovicë dhe objekte të tjera kulturi. Një nga burimet, përmes të cilëve ka marrë një përhapje të tillë bektashizmi në Vlorë, Kurvelesh, Përmet, Gjirokastër dhe në krahinat përreth, lidhet me pjesëmarrjen e burrave dhe djemve nga këto anë në shërbimin ushtarak (si jeniçerë), të cilët kur kthenin në vendlindje ngritën objekte të kultit dhe përhapën kulturën bektashiane.

Bektashizmi e ka të ndritur emrin dhe veprën e Abaz Aliut, i cili mendohet se ka ardhur dhe në malin e Tomorit, por në Labëri ai përmendet në këtë mënyrë: "Për Abaz Ali, për atë diell e për atë dhe!", pra përmes kultit të diellit dhe dheut. Ky kult i Abaz Aliut është mishëruar shumë, saqë në malin e Çipinit apo të Trebeshinës, në Bohotinë apo në Tomor, zakonisht kur lind dielli, shekujve të kaluar banorët i bënin kurban në fillim të gushtit, duke iu drejtuar qiellit, ndërsa në

malin e Shashicës Abaz Aliut i kushtonin kultin e shtimit të blegtorisë. Po kështu, në Tërbaç banorët i faleshin shkëmbit Bridash në malin e Çikës për nder të Abaz Aliut, siç ndodhte edhe në Shendelli të Borshit, ku bekoheshin krojet për nder të këtij shenjt.

Përhapja dhe ndikimi që bektashizmi kishte në Vlorë dhe në të gjithë Labërinë, duke qenë pjesë e zhvillimeve social- historike të kohës e dëshmojnë shumë burime të tjera autentike, që vijnë nga të huajt, që nga Elvia Çelebia (1611- 1684, një kronist i njohur i Perandorisë Osmane), studiuesi M. Leake (1777-1860), H. Holland (1799-1873), F. Pouqueville (1770-1838) Amalia von Godin (1914), Margaret Hazluk (1934) dhe shumë burime të tjera. Ashtu si Baba Tomori dhe Kuzum Babai përcjell një legjendë të njohur, si njëra nga qendrat dhe vendet e shenjta të bektashizmit në Vlorë.

Një vend të veçantë në përhapjen e bektashizmit në jug të vëndit ka edhe veprimtaria e baba Demir Hanit. Studiuesi Osman Myderizi në "Buletin për shkencat shoqërore", nr. XI/1, Tiranë 1957, fq. 177-200, na thotë, se duke u njohur me disa dorëshkrime bektashiane, midis tyre është ndeshur me "Biografia e Demir Hanit", tyrbja e të cilit e ngritur në Tepelenë më 1629-1630 "u bë vend pelegrinazhi shumë i rëndësishëm në Shqipërinë e Jugut, sidomos për bektashianët"

Në Jug të Shqipërisë kanë qenë të shumtë ata klerikë, që kanë lënë gjurmë të thella në përhapjen e bektashizmit si: Baba Hajdari (Gjirokastër), Baba Ali Mesapliku (Smokthinë), Baba Abdullahi (Selanik), Baba Ali Turani (Tepelenë), Baba Sulo Progonati, Baba Sali Matohasanaj (Tepelenë), Baba Ismaili (Gllavë), Baba Medini (Gllavë), Baba Mustafai (Memaliaj), Baba Selmani (Rabie), Baba Ahmeti (Koshtan), Baba Sejfulla Melani (Nepravishtë), Baba Selimi (Gjirokastër), Baba Ahmet Turani (Tepelenë), Baba Alushi (Frashër), Baba Abedini (Frashër), Baba Fetahu (Backë), Baba Ali Qafoku (Tomor), Baba Abedini (Leskovik), Baba Meleq Shembërdheni (Skrapar), Baba Sali Njazi Dedei (Kolonjë), Baba Ali Tomori (Shalës – Tepelenë) baba Sulo Rama, Krahas etj.

Labëria historikisht është dëshmuar si njëra nga krahinat me ndjeshmëri shumë të lartë lidhur me zhvillimet politiko historike. Rreth viteve 1828 në kuadër të reformave të Perandorisë Osmane, teqetë e bektashinjte e Vlorës, Tepelenës, Gjirokastrës, Përmetit, Sktaparit e kundërshtuan këtë reformë të egër, e për pasojë u shkatërruan rreth 13 teqe. Në vijim të kësaj kohe ka dhe një dëshmi tjetër interesante, që lidhet me qëndrimet patriotike- atdhetare të bektashinjve të Vlorës. Në vitin 1878, një vit i njohur në kalendarin shqiptar, tregohet se Babai i teqesë së Kuzum Babait ka dhënë një lutje, në të cilën është thënë se ai ka parë një ëndërr, se një fat i bardhë fluturonte mbi qiellin e Shqipërisë, se shpëtimin nga Porta e Lartë do ta kishim nga Austro - Hungaria dhe vendet tjera të botës moderne. Kjo profeci është përsëritur edhe nga Teqeja e Tepelenës, e Gjirokastrës dhe e Frashërit në Përmet.

Ky moment, sipas konsullit austro-hungarez në Janinë përbënte lajm të tmerrshëm për Portën e Lartë, prandaj u kërkua shpjegim, por ndërkohë Lidhja Shqiptare e Prizrenit e kishte shpallur programin politik, më pas u zhvillua

Konferenca e Berlinit, në të cilën diskutohej fati i vilajeteve shqiptare, por profecia e ëndrrës së babit të teqesë së Kuzum Babit u vërtetua. Ndërkohë bektashinjtë e teqeve të Vlorës, Tepelenës dhe Beratit u përfshinë në veprimtarinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Në një veprimtari patriotike të dukshme u përfshi dhe baba Sali Beqiri i Tepelenës, i cili u internua nga pushtuesit turq në Tripoli e vende të tjera të largëta.

I njohur dhe më i rëndësishmi në historinë shqiptare është ai i shpalljes së Pavarësisë, një sakrificë e nisur që herët dhe që u kurorëzua me 28 nëntor 1912 në Vlorë. Në këtë eveniment të madh njerëzit e të gjitha besimeve shqiptare ishin bashkë. Kështu u dëshmuar Atë Marko Moçka (besimi ortodoks), Haxhi Muhamedi (mysliman), Dom Nikollë Kaçorri (katolik) dhe baba i teqesë së Vlorës, Baba Sali Matohasanaj, të cilët krahas Ismail Qemalit bekuan flamurin e Pavarësisë.

Gjatë viteve të totalitarizmit, aktiviteti i urdhrit bektashi u hesht si për të gjithë besimet e tjera, por pas rënies së autoritarizmit dhe diktatit ideologjik të partisë - shtet, bektashizmi në Vlorë dhe në të gjithë Labërinë e Tepelenën është gjallëruar. Teqeja e Kuzum Babait ka afruar rreth vetes jo vetëm besimtarët e vjetër, por dhe ata të rinj, të cilët kanë sjellë një frymë të shëndetshme në këtë drejtim. Teqeja e Kuzum Babait, si qendra kryesore për Vlorën dhe krahinat, në vitin 1998 arriti të ngrejë tyrben e Kuzum Babit, duke e shndërruar atë në një objekt kulti të një rëndësie të veçantë. Është punuar për ringritjen dhe restaurimin tyrbeve dhe teqeve, që mbulon Gjyshata e Vlorës në Vlorë, Drizar, Kapaj, Hambaraj, Kurorën e Malit Sevaster dhe ndonjë vend tjetër.


Mendoj se është e rëndësishme të bëhet i njohur kontributi i njerëzve, të cilët kanë shërbyer në urdhrin bektashi, duke i sjellë vendit një shërbim të rëndësishëm kulturor, atdhetar, patriotik, arsimor, humanitar, që nis që herët, që nis me Sinan Pashën, me Ali Pashë Tepelenën, më pas me Sanxhakbeun e Beratit Ibrahim Pashë Vlorën, dhe nipi i tij Mustaf Pashë Vlora (nënkryetar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit) xhaxhai i Ismail Qemalit, më pas Mahmut bej Vlora, vëllezërit Frashëri e në veçanti apostulli i kulturës shqiptare – Naimi, Ismail Qemali (themeluesi i Pavarësisë dhe shtetit të parë shqiptar), Baba Ali Mesapluku (këshilltari i Ali Pashë Tepelenës), të gjithë të besimit bektashi dhe produkt i kulturës bektashiane.

Mendoj se duhet një kontribut i rëndësishëm, përkushtim dhe studim i hollë lidhur me këto kontribute, mbi traditën, kushtet, rrethanat, ndikimin që bektashizmi ka pasur për të nxjerrë figura të rëndësishme në rëndësinë e fateve të vendit, si dhe traditës bektashiane atdhetare, patriotike, kulturore dhe arsimore.

// Shuhet myhibi fisnik //

REFET HAXHIU

Këtu e 20 vite të shkuara, në ballkonin natyror të teqesë së SariSalltikut, në Krujë, më ka lënë gati pa frymë një rrëfim i myhibit Refet Haxhiu. Takoheshim për herë të parë dhe sapo mësoi se isha nga Drizari i Mallakastrës, pashë se si e çoi vështrimin në dallgët



e Adriatikut, duke u përhumbur s'di se ku. Pas disa minutash, duke mos e ndarë dorën time mes pëlëmbëve të buta të tij, as vështrimin në Adriatik, tha si me gjysmë zëri: "Reshat Bardhi s'bën më nëna. Zoti e ka bërë durimtar të madh!".

Me një kthjelltësi të habitshme, rrëfeu pastaj për tetorin e vitit 1959, kur së bashku me vëllanë, Ismailin, patën udhëtuar nga Kruja për në Drizar, të takonin dedein dhe dervishin.

Emrat e tyre i përcillnin krenarisht vetëm kur ishin në muhabetë bektashiane, ndërsa në punë apo në shoqëri tjetër, u thoshin thjeshtë: dervishi dhe dedei. Instiktivisht, ajo përkujdesje enigmatike e myhibëve dhe dashamirësve bektashianë për myrshidët e tyre, shfaqej shumë e kujdesshme, deri në përvuajtje, sepse ingranazhet e makinerisë së shtetit që sulmonte Zotin, ishin jo rrallë të pamëshirshëm. Vitet që rrodhën shpërfillën keqas këtë kështjellë rëre të ateizmit, por sidoqoftë besimtarët bektashianë të Krujës dhe



Bujaria, në çdo frymëmarrje të tij

të gjithë Shqipërisë duhej të ecnin përmes lumenjve të sakrificave gjithfarësh.

Shkuarja në Drizar, ndonëse ilegale, ishte e mahnitshme, më pat treguar atëherë Refeti. Sepse përpara se të shkonim, ne flisnim me ata myhibë ose ashikë krutanë që i besonim dhe na besonin. Sikush prej tyre donte ta kishte një kontakt me dedein dhe dervishin, prandaj dikush dërgonte një letër, dikush pak ushqime, dikush ndonjë nijaz, dikush ndonjë kursim në lekë. Sidomos letrat, ishin pa fund. Përmes tyre, dedei dhe dervishi ishin në dijeni të gjithçkaje që ndodhte në Krujë, që nga lindjet e vajzave dhe të djemve, tek fejesat, martesat dhe deri tek kalimi nga kjo botë i të afërmve të tyre. Dikur në Anadollin e largët, dervishët i identifikonin me pëllumbat e Haxhi BektashVeliut, që shpërndanin urtësi pa ndërprerë. Ne ngarkoheshim me plaçka, ushqime dhe letra, duke iu drejtuar Drizarit, i cili, porsa shkëlqim tek rrapit i Vodicsës dhe pinim ujë, duke sjukur na uronte: "Po hajdeni o të bekuar!"

Në darkë vonë, kur bisedonim pranë oxhakut, vëllaim, Ismaili i tha dedeit se djalin, Dilaverin e kishte pak të sëmurë. Dedei i dëgjoi deri në fund pa folur. Ramë të flinim dhe të them të drejtën, unë u bëra merak se dedei nuk tha asgjë për sëmundjen e nipit tim. Edhe në mëngjes herët kur do të niseshim, ai e kapi Ismailin nga dora, pa nga qielli dhe bëri një dua, gati sikur po i këndonte një fëmije për ta vënë në gjumë. Aq butë. Me një "të fala të gjithë djemve dhe vajzave të Ehli-Bejtit", ne morëm teposhtë rrugën dhiare që të çonte në Fratar dhe po atë natë vonë, ishim në Krujë. Gjatë rrugës folëm fare pak dhe unë i thash Ismailit kur shkuam në shtëpi: "do vij ta shoh pak Dilon e vogël!" Kur i ramë portës, o Zot i Madh! Portën na e çeli Dilo i buzëqeshur!

Kur e pata pyetur dikur dede Reshat Bardhin për besimtarët krutanë, midis sa e sa të tillëve, të devotshëm, të urtë, të heshtur, ai më përmendi dhe Refet Haxhiun. "Vshhtë bujar, me shpirt të madh, tha ai. Më tej më rrëfeu se si në vitet e vështirë të ndalimit të fesë në Shqipëri,

shtëpia e Refetit ishte e hapur për çdo gëzim bektashian. Ai vetë kishte qenë aty i pranishëm në ditën e ashures në vitin 1977, në mesin e 40 besimtarëve të tjerë, në kujtimin e vyer të betejës së Qerbelasë, në respektin e pakufi të veprës së Imam Hysenit. Dhe imagjinoni çfarë heroizmi ishte, të ishte bujar me Zotin, në ato vite kur mund të provoje dhe hekurat e burgut, të hapje dyert e shtëpisë për ngjarje që "njeriu i ri" as duhej t'i shkonte nëpër mend.

Një bujari e tillë, është një stacion i bukur trimërie në udhëtimin për tek Haku. I famshmi Bejazid Bistamiu, rrëfen diku se donte të kalonte nga njeri breg i lumit Tigër, në bregun tjetër. Kur ishte gati për të arritur, dy brigjet u bashkuan për t'ja lehtësuar sadopak udhëtimin e njeriut të shenjtë. Bistamiu, kur pa këtë akt, i tha lumit: "Përgjërohëm se unë nuk gënjehem nga kjo çfarë bëre. Sepse lundraxhinjtë e nxjerrin njeriu matanë për gjysmë akçe. Ndërsa ti, kërkon shpërblimin e punëve të mira në tridhjetë vite. Por unë kurrë s'mund t'i çoj dëm, të mirat që kam bërë për ditën e ringjalljes, vetëm për gjysmë akçeje. Mua më duhet bujaria, jo mrekullia!"

Të tetëdhjetë e pesë vitet e Refetit, janë tetëdhjetë e pesë shkallë të mundimshme të asaj që rëndom e quajmë kohë fizike. Rrjedha e kësaj jete njerëzore ka kaluar sigurisht për përmes adhurimit për Zotin, për myrshidët, për vetë familjen e madhe të tij shpirtërore dhe atë biologjike. Ajo ka qenë aq e pasur në bujari shpirtërore, sa vështirë të mos afrohesh pranë saj dhe të mos ndjesh gurgullimat e kopshteve të xhenetit.

E transmetuar tek e përvuajtura e dëlirë, Dëshira, tek fëmijët që la pas, bujaria e përvetshme e Refet Haxhisë, sikundër bujaria e çdo bektashiu deri në këndin më të largët të tokës, do të na mbajnë frymën dhe hapat, për t'iu afruar gjërave të vdekshme të kësaj bote dhe flatra zogu për t'iu afruar mirësive të tarikatit. Çfarë duam më tepër?

Syrja Xhelaj
Krujë, shkurt 2020

Thellësitë

Rrugët e jetës njerëzore nuk janë as të lehta as të thjeshta. Shpesh, shumë shpesh të shpiejnë nëpër dhembje, vuajtje, sprova e pengesa. Gëzimet e buzëqeshjet nuk janë përcjellësit e vetëm në shtigjet jetësore. Gjatë tërë jetës njerëzore ndërrohen ditët e ngrohta, me freski dhe diell, me ditët e dimrave të ashpër, me stuhi, me re të zymta.

Çdo njeri has në pengesa. Edhe ti, o njeri i ri, sigurisht ke hasur në to. Ndoshta, veç e ke shijuar hidhërimin e dhembjes, të vuajtjeve dhe të lotëve. Po të pyes, a ke enë ndonjëherë i sëmurë? A ke humbur dikë, që e ke pasur të afërt dhe të dashur? A ke përjetuar zhgënjim për personin që e ke dashur, e ke nderuar dhe e ke çmuar? A ke pësuar disfatë në shkollë, në studime? A ke përjetuar poshtërimin nga mendjemëdhenjtë e krekosur? A ke pësuar mos-sukses në punë? Pyetjet mund të radhiteshin pa fund. Sepse format e vuajtjeve janë të pafundme, përjetimet e tyre të shumta. E vuajtjet dhe pësimet janë ligje të pamëshirshme të jetesës. Ato janë pjesë e jetës sonë. Njeriu e mban në vete dhe rreth vetes. E përse dhembjet dhe vuajtjet?! - do të pyesë dikush. Përse nuk ka gëzim të amshueshëm dhe fytyra të ndritshme, jetë të lumtur? Përse vetëm lot e vaj?

Besimtari dhe besimtarja do të përgjigjen: Unë këtë nuk e di sigurisht. Por e di i Dashuri im, All-llahu xh.sh.! ndoshta Ai, nëpërmjet dhembjeve, dënon për të kaluarën mëkatore dhe të pakuptimtë. Ndoshta Ai e kalit njeriun për ardhmëri, që ta forcojë, ta bëjë të fuqishëm, ta bëjë trim, që trimërisht t'i presë vuajtjet edhe më të mëdha. Ndoshta All-llahu, nëpërmjet dhembjeve, do t'ia hapë njeriut sytë për seriozitetin e jetës, t'i paraqesë horizontet më të reja e më të thella të besimit. Ndoshta atë që vuan, e pastron nga mëkatet e kaluara, dhe ia përgatit xhenetin dhe shkallët më të larta të xhenetit. Por, ndoshta, me anë

të vuajtjeve, dëshiron që ta fisnikërojë njeriun, që ta bëjë më të mirë, më bujar e më të virtytshëm.

Çdo hidhërim, çdo pësim dhe çdo vuajtje, janë sprova që All-llahu xh.sh. na i dërgon. Sepse besimin në zemrën e vet, besimtari duhet ta dëshmojë patjetër edhe me anë të sprovës. Sprova është provim për besimtarin, provim për besnikëri ndaj All-llahut të Plotfuqishëm e Mirëbërës. Sprova është pjesë e jetës. Edhe besimtari nuk do ta kalojë rrugën jetësore pa sprovime, dhe këtë Zoti e di më mirë. All-llahu xh.sh. në Kur'anin e madhërishtëm thotë: "Ne do t'ju sprovojmë me ndonjë frikë me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, po t'i jepja myzhde durimtarëve. Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndshme, thonë: "Ne jemi të All-llahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi. Të tillët janë që te Zoti i tyre kanë bekime e mëshirë dhe të tillët janë ata të udhëzuarit në rrugën e drejtë." (Kur'ani, 2:155-156)

"Po ju menduat se do të hyni në xhenet, pa u provuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para push, të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet dhe qenë tronditur, saqë i Dërguari thoshte, e me të edhe ata që kishin besuar: Kur do të jetë ndihma e All-llahut?! Ja (u erdhi ndihma) vërtet ndihma e All-llahut është afër!" (Kur'ani, 2:214)

Këto fjalë të All-llahut duhet të jenë idetë e zemrës dhe të shpirtit të çdo besimtari. Ato duhet ta frymëzojnë besimtarin drejt lartësisë së vërtetë e të thellë të besimit me vlerë të pakufishme. Nëpërmjet sprovave, pësimeve, All-llahu kërkon zemra burrërore besimtare, kërkon kreshnikë të fesë. Kur pasojnë furtunat e sprovave, lufta në zemër, lufta në shpirt, kërkon trimëri personale, të mbrojtur nga shikimet dhe mirënjohjet. Fuqia e besimit në këto çaste është në provim. Dashuria ndaj All-llahut është në provim.

Besimtari, besnik ndaj fesë së vet, në tejkalimin e hidhërimit të vet, do të tregojë dashurinë e vet të

e besimit

pastër ndaj Zotit. Në emër të kësaj dashurie ai do ta mbizotërojë dhembjen e hidhërimit në vete, dëshpërimi do të ikë para tij. Në këtë vetëhidhërim nuk ka mashtrim, nuk ka vetëshquarje. Këtë hidhërim askush nuk e sheh, përveç All-llahut, dhe pikërisht aty qëndron madhështia e vlerës së tij.

Si kristal i kulluar shndrit besimi i argumentuar dhe i dëshmuar. E zoti pikërisht besim të këtillë kërkon. Njëra nga rrugët për manifestimin e një besimi të këtillë të çeliktë, të paluhatsëm, të fuqishëm është edhe besimi nëpërmjet vuajtjeve dhe pësimeve. Ndërsa dashuria e pastër ndaj All-llahut shpie në lartësitë më të mëdha të besimit, të cilin mund ta arrijë njeriu. Ç'bëjnë njerëzit kur i godasin vuajtjet dhe fatkeqësitë, kur buzëqeshjet zëvendësohen me lot, kur gëzimin e zëvendëson hidhërimi?

Disa dekurajohen e molisen, i dorëzohen dëshpërimit, hidhërimit, vajit, humbin besimin në vetvete. Në lot, në ofshama, në gjëmë, në britma, në vajtim, kërkojnë shpëtim? Këta janë qyqarë, që nuk kanë as fuqi, as guxim. Ndërsa disa të tjerë me zemërim i shtrëngojnë grushtet dhe qortojnë, shajnë gjithçka rreth vetes. Fajësojnë çdo gjë rreth tyre. Ata tërbohen, mallkojnë. Zemërimi shpërthen nga çdo fjalë e tyre, nga çdo shikim. I gjuajnë sendet rreth vetes, përplasnin dyert, bërtasin dhe bëjnë zhurmë në pikëllimin dhe dëshpërimin e tyre të pakuptimtë. Këta janë shpirtra të vrazhdë qyqarësh, të mësuar me dëfrime e llastime. Këta janë shpirtra, që nuk dinë për vuajtje dhe nuk kanë fuqi t'i pranojnë dhe t'i kuptojnë si thirrje.

Disa njerëz, ndërkaq, i përballojnë me guxim vuajtjet dhe hidhërimet. I kuptojnë si domosdoshmëri që i ka goditur, si të vërtetë dhe si provë, që Zoti i Dashur ua ka dërguar me qëllim të qartë dhe të caktuar. Ata në dhembje dhe në hidhërim gjejnë kuptim, qëllim, që Zoti u ka urdhëruar. Ata janë të

tillë, që besojnë në caktimet e Zotit ndaj janë në gjendje që heroikisht t'i përballojnë fatit të vet. Në zjarrin e vuajtjeve, në sprova, sado të shumëllojshme dhe të rënda që të jenë ato, ata do të kërkojnë zgjidhje në kuptimësimin e durimit, të ndërldhur me besimin dhe dashurinë e pakufishme ndaj Allahut xh.sh.

Ata dhembjen do ta shfrytëzojnë për të forcuar besimin e tyre, për ta fisnikëruar shpirtin e vet dhe veprat e veta. Pas përballimit të vuajtjeve njeriu bëhet më i mirë, më fisnik, më i vyer, më i mëshirshëm, më serioz! Ti e di se hekuri kalitet në flakën e zjarrit. A thua hekuri i pakalitur do bëhej ndonjëherë çelik, sikur të mos ishte kalitur në zjarr? Edhe ai, sikur të kishte pasur mundësi, do të fliste për dhembjet e veta, të cilat i përballon nga të rënat e çekanit në flakën e zjarrit, mirëpo ai do të fliste edhe për formën e vet më të lartë e më të përsosur që e arrin në procesin e kalitjes.

Sigurisht ke dëgjuar për arabeskat shumë të bukura të skalitura në gur, në xhaminë e Kordovës. Njerëzit qëndrojnë të magjepsur para tyre. Gjithçka që të thuhet para veprës së mrekullueshme të mendjes njerëzore, dorën në zemër, vetëm do ta zhvlerësonte bukurinë e këtyre ornamenteve. Pranë arabeskave, të cilat i ka gdhendur dora e artistit, vetëm duhet heshtur duke e madhëruar emrin e Allahut, i cili u ka dhuruar aftësi të këtillë skalitësve të panjohur. Dhe tani kujto se si kanë fluturuar xixat nën daltën e artistit, se si ndërmjet të goditurave të daltës nga një gur i madh, i thjeshtë e i papërpunuar, ka lindur dëshmia madhështore e mjeshtërisë njerëzore dhe frymëzimi i Allahut. Pa xixa dhe pa të rëna nuk do të kishte lindur kurrë një vepër e tillë!

Dhe ashtu siç kalitet çeliku në zjarr dhe ashtu siç përpunohen nën daltë dhe me goditjet e çekanit

formohen arabeskat, kështu edhe nga njeriu i thjeshtë, nën goditjet e dhembshme, formohet njeriu fisnik me karakter shembullor. Romakët e vjetër thoshin: "Ari provohet në zjarr, kurse trimat në ditë të vështira".

Edhe vuajtja mund të jetë e dobishme, fisnike dhe krenare. Të llastuarit, të përkëdhelurit, kënaqësitë e përhershme, lehtësitë dhe rrugët pa gjemba e ferra nuk i edukojnë njerëzit e rinj për jetë serioze, e cila kërkon trima të shkathët, të guximshëm dhe të patrembur. Njeriu i përkëdhelur dhe delikat është sikur lulja e kultivuar në kopshtin qelqor. Atë e dëmton çdo acar, madje edhe puhia më e lehtë. Djemtë dhe vajzat e përkëdhelura janë si kanarinat e kultivuara në kafaz, të cilat, në kontaktin e parë me natyrën, e humbin rrugën. Edhe mundimi më i vogël, ata i dërmton dhe i asgjëson.

Njerëzit, të cilët në rini kanë duruar dhe kanë vuajtur, në moshën e shkuar do të dinë t'u përballojnë të gjithë vështirësitë, që u ndodhin. Ata nuk vajtojnë, por gjithmonë do të dinë të qëndrojnë në këmbë. Ata, edhe kur të rrëzohen, pas çdo rënie, ngrihen përsëri.

Në Holandë është një krahinë që quhet Seeland (toka e detit), e cila e ka shtratin në nivelin e detit. Nga valët dhe stuhitë e detit ajo mbrohet me penda të mëdha. Nganjëherë deti i shpërthen pendat, kurse njerëzit, me fuqinë e trupit dhe të shpirtit të tyre, me punë të qëndrueshme e shterin ujin e detit vërshues, e thajnë përsëri tokën dhe e heqin kripën nga ajo. Qëndresa dhe durimi i tyre është shprehur edhe në stemën e krahinës, ku qëndrojnë të shkruara fjalët: "Luftoj dhe përsëri e çoj kokën lart". Pas vuajtjeve dhe dështimeve gjithmonë duhet ngrehur kokën lart, e nuk duhet ligështuar.

Psikologu dhe pedagogu amerikan Xhems thotë se, njerëzit e rinj çdo ditë duhet t'i nënshtrohen ndonjë veprimi, që do të kërkojë prej tyre durim dhe forcë vullneti, kështu që me kalitje të piquen për trimëri, për vendosmëri në rrugën burrërore. Njerëzit e rinj nuk duhet t'i mbrojmë prej çdo dëshpërimit, qoftë ky edhe më i vogël. Fatkeqësitë e forcojnë shpirtin e njerëzve të rinj, e forcojnë karakterin e tyre, e nxisin mëshirën e dhembshurinë për njerëzit e tjerë. Vuajt-

jet fisnikërojnë. Vetëm shtigjet e ngushta me gjemba çojnë në majat më të larta të maleve.

Kush dëshiron të qëndrojë në sprovat morale, duhet të forcohet. Kush dëshiron t'i rezistojë të ftohtit, duhet të qëndrojë më parë në acar. Ai që do të ketë muskuj të fortë, duhet t'i ushtrojë shpesh. Ai që dëshiron të ketë mendjemprehtësi që të arrijë shkallë të larta të dijes, vijimisht duhet të bëjë përpjekje në këtë drejtim. Të gjitha këto kërkojnë punë, mund dhe durim. Prej të gjitha këtyre nuk duhet frikësuar, për këto du-het shfrytëzuar, duke i shndërruar në akt fisnik.

"Çdo fatkeqësi nuk është mallkim. Vetëmohimi dhe vuajtja shpesh janë bekim. Tejkalimi i vështirësive me durim nuk na shërben vetëm për mësim, por na forcon edhe për sprovat të ardhme" (Sharpe). Pa dhembje nuk ka degëza ulliri, pa prova s'ka miq, pa hidhërim s'ka famë.

Romakët e vjetër thoshin: "Fatkeqësia është rast për të treguar virtytet". Njerëzimi jeton dhe përparon me dhembje. Me dhembje krijohen vepra të mëdha. Në gëzim njerëzit janë të cekët, në dhembje janë më të thellë. Dhembja, vetëm dhembja e jetuar, është në gjendje ta trondisë shpirtin njerëzor, që nga ai, të thithë atë që është më e mirë, pastaj i dhuron njerëzimit vepra të mëdha në art, në letërsi, në shkencë. Dhembja dhe vuajtja janë shoqëruese të paevitueshme të jetës sfidë, prej lindjes deri në vdekje. Prandaj duhet të pranohen si pjesë përbërëse të jetës sonë. Në dhembje dhe vuajtje nuk duhet ligështuar.


Kuptohet se nuk duhet të kërkojmë dhembje e vuajtje. Mirëpo, kur të na ndodhin, duhet t'i pranojmë me besim në Allahun xh.sh., t'i pranojmë si mundësi, t'i pranojmë me durim. Dhembjes i duhet dhënë kuptim, duke e shfrytëzuar për rilindje frymëzimi. Edhe nga vuajtjet duhet nxjerrë mësim. Duhet ta forcojmë besimin dhe ta pastrojmë atë, sepse besim të këtyllë Allahu xh.sh. kërkon prej nesh! Historia njerëzore është përplot me dhembje, vuajtje e pësime, por edhe mendje të mëdha, njerëz të mëdhenj, vepra të mëdha humane, të rritura nga zjarri i vështirësive dhe i mundimeve.



NË GJURMËT E DERVISH ILJASIT

Nga: ENVER KUSHI


Kur mbaron së lexuari librin më të ri të Nuri Çunit “Gjurmët e Dervish Iljasit”, duket se edhe ti si lexues ke bërë një rrugëtim të gjatë në kohë dhe hapësirë me dervish Iljasin. Jo vetëm kaq: ke dëshirë të shkosh në viset ku ai ka lindur dhe është madhuar, të ngjitesh në Kulmak, ndoshta në një natë dimri me dëborë e suferinë, ku nga larg sheh një fener të ndezur, që të drejton për në teqenë e famshme e ku dervish Iljasi të pret me fjalët: ” Edhe gurët, edhe drurët ju falenderojnë që erdhët...” Dhe pastaj të ecësh e të ecësh në gjurmët e dervish Iljasit, që janë sa shpirtërore, aq dhe lëndore e të prekshme. Me të drejtë, në mesazhin e Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, për këtë libër, shkruhet : “Është thirrje brenda nesh, që gjurmët e ndritura, jo vetëm mos t’l lemë të pluhurosen, por përkundrazi, të ecim mbi to, të frymëzohemi prej tyre, duke i dhënë jetë e gjallëri bektashizmit në Shqipëri dhe në botë. Ky libër përcjell nga fillimi në fund veprën e dervish Iljasit, mesazhin bektashian të pafikur çirakun e Haxhi Bektash Veliut”. Autori i këtij libri, Nuri Çuni, është një nga njohësit e mirë të historisë, kulturës dhe mistikës bektashiane. Ky njeri me shpirt të madh e i palodhur, me një përkushtim të veçantë shpirtëror, nëpërmjet shumë botimeve, ka shkruar për historinë e teqeve bektashiane në Shqipëri, ndihmesën e bektashinjve në Lëvizjen Komëtare Shqiptare, figurat e shquara të klerit bektashian etj. etj. Kjo nuk është e rastit. Ai ka lindur në Sevran, një fshat që ndodhet në jug-perëndim të malit Tomorr dhe që i vogël, ka marrë shumë nga mistika dhe drita që vjen nga ai mal “i shenjteruar i shqiptarëve”, siç thonë rilindasit tanë të ndritur. Trekëndëshi i shenjtë (nëse do shprehesh këshu), Mekami i Abas Aliut, teqja e Kulmakut dhe teqja historike e Prishtës, kanë rrezatuar në shekuj dritë jo vetëm për ato treva, por për tërë kombin shqiptarë, ndërsa në vetëvete, Tomorri ka përshtatur në thellësi të tij e në sipërfaqe, mite, legjenda, rrëfenja nga më të çuditshmet, këngë etj. etj. atë që do ta quaja Tomorriada. Me të drejtë Mit’hat Frashëri në një nga



rrëfenjat e tij më të bukura të titulluar “Ay mal”, shkruar në vitin 1914, mes të tjerash shprehet për Tomorrin: “Edhe shpes i malevet këtu vjen dhe kërkon fuqi për krahët; shqiponja këtu e mpreh sqepin, kaprolli këtu u jep ujë këmbëvet të çelikta, ret ‘e qiellit këtu vinë dhe mbushen me shi, dëborë këtu zbardhet, rrufeja këtu e merr zjarrin. Rri e patundur kjo majë. Ruan Shqipërinë. E ka pushtuar me shikimin e saj”. Eposi Tomorrian ose Tomorriada ka qenë dhe mbetet i lakmuar për historianë, studiues të fushave të ndryshme, poetë e prozatorë, piktorë, kompozitorë... Mali i shenjtë i Tomorrit, veçanërisht tek bektashinjte ka simbolikën e malit baba, që jep dashuri, mirësi, paqe e mbrojtës të Shqipërisë. Jeta dhe vepra e Nuri Çunit janë të lidhura pazgjidhmërisht me frymën dhe dritën që vjen nga ai mal, me eposin dhe lirikën e Tomorriadës, gjurmët e thella të bektashizmit dhe klerikët e këtij tarikati, që kanë shërbyer në ato vise “ku bektashizmi ka shtëpinë e vet”, siç shkruan poeti Xhevahir Spahiu. Vite më parë, në fillim qershorin e vitit 2015, kur kishim nisur xhirimet për filmin dokumentar “Teqetë e Shqipërisë”, pas natës që bujtëm në Bogovë, si të ftuar të Zalo Qatos, nuk do ta harroj kurrë mëngjesin, kur po ngjiteshim në shpatet perëndimore të Tomorrit. Shkoja për herë të parë në ato vise nga

më të bukurat e Shqipërisë, ku përshfaqej kudo aura e shenjtërisë dhe drita e atij mali. Operatori i mirënjohur Spartak Papadhimitri dhe skenaristi e regjisorit pasionant Kreshnik Hashorva, ndaleshin për të fiksuar në kamera dhe aparatin fotografik bokërrimat, luginat e thepësura, korijet me lisa, retë që uleshin e ngriheshin mbi shpatet e thepësura e majat e larta. Nuri Çuni, që njihte çdo pëllëmbë të atyre viseve, fliste pa pushim, ndërsa makina ngjitej me vështirësi në rrugën malore. Dhe teksa ndiqja rrëfimin e tij, më dukej sikur prekja legjendat dhe historinë apo takoja baballarët dhe dervishët bektashinj, që ecnin atyre rrugëve me heshtjen e thjeshtësinë karakteristike. E mes tyre herëherë më shfaqej, si i zbritur nga retë, dervish Iljasi, një nga klerikët bektashinj më të njohur e gjurmëlënës në ato hapësira e vise. Mbaj mend që Nuriu i tha shoferit që të ndalte makinën. Përpara nesh ishte një korije me lisa të mëdhenj dhe duke ndjekur nga pas Nuriun, u befusam nga ai vend i mrekullueshëm dhe dy lisa të veçantë, monumente të rralla natyrore. Vendi quhej Pirogosh dhe mes korijeveme lisa ishte pusi ndërtuar nga dervish Iljasi, 13 metra i thellë. Kur përfundoi pusi, dervishi mori dy fidana lisi, i fërkoj pas shpatullave të tij, i bekoj dhe tha fjalët: “Lisat do të rriten për hije, që të pushojnë udhëtarët e lodhur, pranë pusit me ujë”. Ne dëgjomim me vëmendje rrëfimin e Nuriut, duke parë lisat madhështorë mbi një shekull, trangu i të cilëve ka diametrin 130 – 140 cm. Nuri Çuni na foli gjatë për veprimtarinë ndërtonjëse të dervish Iljasit, si rrugë, ura, puse, çezme... Në të folurën e tij dhe rrëfimet me një kolor të veçantë, m’u duk sikur lexoja librin e tij të ardhshëm për dervish Iljasin, këtij kleriku emblematik të bektashizmit shqiptar e më gjerë. Tashmë ky libër është në duart e lexuesit, shoqëruar në hyrje me fjalën e ngrohtë dhe vlerësuese të Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Autori i librit më besoi korrektimin dhe redaktimin letrar, pra në një farë kuptimi isha lexuesi i parë, ku nga faqja në faqe e deri në fund, kam patur fatin të jem në “shoqërinë” e dervish Iljasit, duke ndjerë dhe fituar shumë shpirtërisht, nga jeta dhe vepra gjurmëlënëse e tij. Lexuesi njihet me një jetë që përtej të zakonshmes apo normales, përfshin ndodhira nga më të çuditshmet, që ruhen të gjalla në kujtesën popullore, në poezi, këngë, rrëfime nga më befusueset, të trashëguara brez pas brezi, shoqëruar me aureolën mistike bektashiane, që i japin kësaj figure një dimension shumëplanësh sa njerëzor, aq edhe të shenjtëruar. Studiuesi John Birge, në librin “Urdhëri Bektashian i Dervishëve”, duke cituar prof. Fuad Koprulu shkruan se sipas tij “pjesa më e madhe e dervishëve të ardhur nga Azia e Vogël ishin të kalender dhe këtë lëvizje kalendere ai e quan një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e islamit. Këta dervishë i ishin përkushtuar jetës së udhëtimit të vazhdueshme dhe të pandërprerë”. Dervish Iljasi në librin e Nuri Çunit ose dervishi kalender, nuk ka ardhur nga Azia e Vogël, por jeta e tij është një udhëtim i pandërprerë në viset shqiptare dhe veçmas në ato që i mbulon hija e malit të shenjtë të Tomorrit. Ai i përket atij brezi të rrallë të personaliteteve të historisë së bektashizmit shqiptar, që të udhëhequr nga çiragu i Haxhi Bektash Veliut, me fjalën, veprën, jetën e tyre, kanë lënë gjurmë të pashlyeshme kudo që kanë shërbyer. Autori nuk e ka patur të lehtë të ndjekë rrugëtimin e gjatë dhe të

hedhë në letër gjurmët e lëna nga dervishi kalender, kudo që ai ka shkelur. Nuri Çunit i është dashur të prekë vetë gjurmët e dervish Iljasit si ato lëndore, pra veprat ndërtonjëse të tij, por edhe ato shpirtërore, mistike. Kjo e dyta ka qenë më e vështirë, por ai, falë pasionit, punës së palodhur, depërton edhe në dimension mistik të dervish Iljasit. Siç e theksuam edhe më lartë, dervishi kalender, por edhe autori i këtij libri, janë lindur e madhuar nën hijen dhe madhështinë e Baba Tomorrit, sepse siç shkruan ai: “Besimi në këtë mal dhe dashurinë për bektashizmin e mori gradualisht në rritje e sipër. Më pas, kur qëndroi për një periudhë kohe në Qendrën Botërore Bektashiane në Haxhi Bektash, krahas njohurive të plota për tarikatin bektashian, mori dorë e u vesh dervish”. Po të lexoni me vëmendje këtë libër, do të gjeni në të dhjetëra ndodhi, ku shpaloset mistika e dervish Iljasit. “Jeta e Dervish Iljasit, nënvizon Haxhi Dede Edmond Brahimaj, ndonëse ishte e shkurtër, ka mbetur gjallë në kujtesën e shekullit që lamë pas, si dhe në kujtesën e brezave të besimtarëve, pikerisht përmes mistikës së shfaqur prej tij... Kështu Kalenteri i vërtetë u bë sinonim i kuptimit “sufizëm”, që me të drejtë quhet rruga drejt Zotit. Urat dhe rrugët që bënte, ai i bashkonte njerëzit të udhëtonin bashkë me njeri-tjetrin...” Veprimtaria ndërtonjëse e dervish Iljasit, përbën një nga shtyllat kryesore të këtij libri. Ndërtimi i urave, referuar shtypit të kohës, veçmas gazetës “Lirija”, ku jepën fakte mbresëlënëse nga puna e palodhur e tij, i cili, siç shkruan ajo: “Shpirtmir punonjës i palodhur Varfa Iljas ka tre vjet me kazëm në dorë katund më katund, ku janë prishur udhët i ndreq, duke u a lehtësuar banorëve të shumtë komunikimin mes njeri-tjetrit”. Lexuesi jo vetëm ndjen dhe prek këtë veprimtari ndërtonjëse të dervish Iljasit, por edhe emocionohet apobie në mendime për forcën e karakterit të tij, largpamësinë e mbi të gjitha punën në shërbim të njerëzve, që u bë moto e këtij kleriku bektashian. “Dervish Iljasi, shkruan autori, ishte një organizator i shkëlqyer, sepse dinte t’u fitonte zemrat besimtarëve dhe dashamirësve. Në popull kishte krijuar besim të plotë dhe me autoritetin e tij fjala nuk i bëhej dysh asnjëherë”. Ky është çelësi i suksesit dhe i punës së palodhur të tij, që arriti kulmin me ngritjen e Teqesë së Kulmakut, më 28 korrik të vitit 1916 dhe mori bekimin e dervish Iljasit: “O Abas Ali! O Abas Ali! Bekuar qoftë kjo teqe!” Nuri Çuni u përcjell lexuesve emocionet e asaj dite të paharruar për besimtarët e dashamirësit e ardhur nga Tomorrica, Gramshi, Skrapari, Berati, Përmeti, Tepelena. Në lartësinë 1,700 metra, në këmbet e Tyrbes së Abas Aliut, ajo u bë shtëpia e mijëra besimtarëve bektashinj, ku u falen dhe i luten Zotit, Muhamet Aliut, Haxhi Bektash Veliut... Në atë Teqe ata marrin bekimet e Abas Aliut dhe qindra shenjtorëve të tjerë, si dhe nga drita e pashuar e bekimeve të Dervish Iljasit. Ai e drejtoi për 7 vite këtë teqe, ku netëve të dimrave të egër e me dëborë të madhe e stuhi, nxirte një njeri me fener në dorë, për t’i orientuar udhëtarët që të shkoni në teqe për t’u ngrohur e shplohur dhe gjetur prehje, nën shoqërinë e Dervishit, që u jepte njerëzve dashuri, urtësi e vëllazëri. Si atdhetar e arsimdashës ai jetoi në një periudhë, kur Lëvizja Kombëtare Shqiptare ishte në kulmin e saj. Ky dimension tjetër i dervish Iljasit, dhënë bukur në këtë libër, e bën më të plotë figurën e tij. Dervish Iljasi i përket brezit të shquar të klerikëve



Shërbim bashkëkohor

Artur Gjinaj
Punonjësi i bibliotekës

Biblioteka e Selisë së Shenjtë Bektashiane fillon historinë e saj me inaugurimin e Qendrës Fetaro-Kulturore Bektashiane me 7 shtator 2015. Mjediset e bibliotekës përbëhen nga salla e leximit me fonde të hapura dhe ajo e arkivit të saj. Salla me fonde të hapura i shërben lexuesve, studiuesve, klerikëve etj. Në këtë sallë çdo lexues ka mundësi të konsultohet drejtpërdrejtë me literaturën që ajo disponon. Kjo sallë i ofron lexuesit mundësinë e akomodimit në një mjedis pune, mikpritës dhe komunikues. Hapësira e arkivit shërben për sigurimin e kopjes unike të çdo titulli, si dhe për ruajtjen e ekzemplarëve të rrallë.

Pas një strukturimi tematik, është realizuar procesi i inventarizimit dhe klasifikimit duke vijuar hap pas hapi me pasurimin e fondeve. Këndi i besimit islam dhe bektashizmit përbëhet nga vepra aktuale dhe retrospektive të autorëve shqiptarë dhe studiuesve të huaj. Ky kënd përmban gjithashtu kuranë në gjuhën shqip dhe të huaj, literaturë filozofike dhe doktrinale, mistike dhe rituale, monografi për profetë dhe personalitete fetare etj. Librat me temë historike zënë një vend të rëndësishëm. Përmes botimeve të kësaj rubrike, lexuesi njihet me përhapjen e bektashizmit në Shqipëri, veprën patriotike, kulturore dhe arsimore të klerikëve dhe besimtarëve bektashianë si edhe biografi dhe punime monografike mbi personalitete të kulturës, shkencës, jetës shoqërore etj.

Një vend të rëndësishëm zënë edhe librat me temë historike mbi përhapjen e bektashizmit në Shqipëri, veprën patriotike, kulturore dhe arsimore të klerikëve dhe besimtarëve bektashianë si edhe biografi dhe punime monografike mbi personalitete të kulturës, shkencës, jetës shoqërore etj. Megjithatë është bibliotekë e profilizuar, nuk janë lënë jashtë vëmendjes librat për gjuhësinë, letërsinë shqipe, përkthime të letërsisë botërore dhe vepra enciklopedike të cilat plotësojnë interesa të veçanta dhe të larmishme të frekuentuesve. Objekt i veçantë i fondit të bibliotekës janë edhe kalendarët vjetorë bektashianë, përmes të cilëve përcillet informacion me të dhëna historike, kulturore, data dhe ngjarje të rëndësishme të kujtesës historike dhe veprimtarisë përkujtimore të besimit bektashian.

Një tjetër zë i rëndësishëm në bibliotekë janë periodikët, ku vlen të përmenden revistat “Urtësia”, “Zani i Naltë”, revista në gjuhën turke “Haxhi Bektash Veli”, gazeta “Dielli i Tomorrit” etj. Jeta dhe veprimtaria e figurave të rëndësishme të klerit bektashian si dhe të besimeve të tjera pasqyrohet më së miri nga albumet e ilustruar. Gjithashtu në brendinë e albumeve trajtohet dhe një larmi tematikash nga fusha e historisë artit dhe kulturës. Pjesë përbërëse e fondit të bibliotekës është edhe letësia artistike për fëmijë dhe të rinj, e autorëve shqiptarë dhe të huaj, e cila zë një mjedis të posaçëm, me një numër të konsiderueshëm botimesh. Vlen të theksohet se pasurimi i mëtejshëm, i shoqëruar me një larmi tematike mbetet një objektiv konstant për Bibliotekën Bektashiane.

bektashinj, që moto të tyre bënë shprehjen lapidare “Pa Atdhe, nuk ka fe”. Nuri Çuni, si në të gjithë librin, edhe në këtë kapitull, mbështetet dhe citon dokumente të shumta arkivore, gazeta të kohës apo botime të ndryshme. Nuk është e rastit, që në kremtimet e 25 vjetorit të vetëqeverimit, dervish Iljasi u vlerësua si përkrahës i nxehtë i arsimit kombëtar dhe që në çdo rast ka dhënë kontributin e tij patriotik për Rilindjen Kombëtare Shqiptare. Në vitin 1937, shkollës së Verzhzhës iu vu emri “Dervish Iljasi”. Këngët dhe vargjet për dervish Iljasin, secila më vete dhe tërësia e tyre, tingëllojnë në kapitullin përmbledhës të këtij libri, si shumësi zerash sa tokësor, aq edhe qiellor. Disa prej tyre janë perla të gurrës popullore të trevës ku janë ngjizur. Kujtesa popullore në këto vargje është me shumë se përjetësi e monument i gjallë për Dervish Iljasin, ku me saktësi përmenden emra vendesh, qytetesh, fshatrash, stinë të ndryshme me gjelbërim, erëra, shira të rrëmbyeshëm vjeshte, deborëra e suferina, apo dritë e bekime që vijnë nga shenjtëria e Dervishit të palodhur e të pavdekshëm. Këto këngë e vargje tingël-

lojnë si zëri magjepsë e tronditës i këngëtarit Demir Zyko, apo shumëzërësia që vjen prej kohërave antike nga mali i Shenjtë i Tomorrit. Studiuesja Iren Melikoff në librin “Pir Haxhi Bektash Veli”, shkruan edhe për një baba me emrin Iljas, që në shek. XIII, ishte prijës fetar popullor, shërues dhe zotërues i një kali të mrekullueshëm gri, me të cilin mund të fluturoje drejt qiellit dhe të zhduket si Mehdiu, për të ardhur përsëri në fund të kohërave. Evla Çelebiu, në disa vargje e paraqet kështu atë: “Sheiku në fronin qiellor dhe me flamur të gjelbër Sheiku me kal gri dhe me çallmën e dritës”. Dervish Iljasi ynë, dervish Iljasi i librit të Nuri Çunit, shfaqet e rishfaqet jo vetëm në kujtesën popullore shqiptare, por veçanërisht ai ka lënë gjurmë në historinë e bektashizmit tonë, jo “i hipur mbi kalin gri” apo “me çallmën e dritës”, por mbi ca kuaj të tjerë mistikë, ku taxhi i dritës dhe harkaja e bardhë, vazhdojnë të ndriçojnë ende, duke lënë gjurmë kudo që ai ka shkelur. Këto gjurmë na i rizbulon që të ecim nëpër to, duke rrugëtuar të ndriçuar nga drita e pavdekshme e bektashizmit.

// The world bektashi Grandfather, His Eminence Haxhi Dede Edmond Brahimaj, participates at the prayers morning in USA

The belief to God, keeps us free

After the invitation of the American States Department, in the month of February of this year, the World Bektashi Grandfather, His Eminence Haxhi Dede Edmond Brahimaj, together with religious leaders from all over the World, participated at the annual event of the Prayers Morning, in the United States of America. This event aims always to reach a possible balance-sheet of the global religious movements and perceptions, pointing out several major problems and discussing in the context of the universality of the belief to the Creator, as a right of everybody, of every nation, of every ethnic group and human minority. Certainly, this Prayers Morning has been always an open-hearted discussion on different ideas and the state or religious leaders try to find solutions of the difficult issues, trending to aspects and useful actions which support the progress of the faith.

During the Prayers Morning of February the participants followed with a special interest the speech of the President of the United States of America, Donald Trump, who; by concrete examples brought to the attention of all the participants that the American nation goes ahead and progress from day to day, united in the liberty of belief, blessed to live in peace and grateful to the contribution of each religion. All of us here, said the President Trump, are united in our conviction, We know that our nation is stronger, our future is brighter, that our joy is greater, when we ask to God to fill our lives with the endless mercy. With all we are doing, we are creating a culture which defends the freedom, which comprises also the religious freedom. We do not take off the crosses. In America we ascend the faith. We nourish the religion. We raise our voice when we pray and our look is always on high, towards the glory of God.

God is always inside us. Before the construction of a sky-scraper in New-York City, thousands of poor American families gave all that they could for the construction of the wonderful cathedral of Saint Patrick. When Buzz Aldrin landed

to the Moon, he said: Houston, I would demand some minutes of silence! After, he read some verses of the Bible. In each phase, the long march of our nation towards the

civil rights was inspired, kept and ascended by the faith, the prayers and the devotion of the religious believers. For defending the faith communities we undertook historical actions, comprising the constitutional right of praying in the public schools.

Yesterday, our administration promoted for the first time, the International Alliance of the Religious Freedom, the first one of this kind, to help the religious freedom. It is really magnificent. More than 25 countries are united already in our campaign. I want to thank the State Secretary Mike Pompeo and the Ambassador Sam Brouback, who are present in this auditorium, for the leadership of this historical initiative. Thank you very much! We, all of us here, reconfirm these eternal verities. The belief to God keeps us free, the prayer makes us strong... We are reinstalling the hope and we are diffusing again the faith. We are helping the citizens of all the origins to participate at the great reconstruction of our nation. We know already that America will brighten always as the earth of freedom for all the nations of the World. This morning let's ask to the Father in Heaven to orientate our steps, to defend our children and to bless our families!

After the Prayers Morning, a special reception was reserved for the World Bektashi Grandfather by the Congressman of USA Michael T. McCaul, who firstly thanked the World Grandfather because his attitude has been always in favor of the initiatives for peace and religious freedom, giving a precious contribution in this field. He said, among others, that he knew and he was pleased because of the perceptions of the Bektashi Holy See concerning the engagements for peace and the concrete activity of the Bektashi communities everywhere in the World and the respect of the basic rights of the exercise of the religious freedom. The defense of this freedom, the enlargement of the eventual interreligious spaces and facing the challenges of the future will be the tests concerning the responsibilities of your Holy See, concluded Mr. McCaul.

The World Bektashi Grandfather, Haxhi Dede Edmond Brahimaj shortly informed the American congressman about the history of the foundation and the development of the Bektashism in Balkans and in other areas of the

World, especially speaking about the national features of this faith in Albania. Independent of the strokes that the Bektashism incurred, especially in the centuries XIX and XX, this tarikat (brotherhood) was able not only to preserve its physiognomy and its philosophy but also to safeguard its best values, as a very precious heritage transmitted to the new generations, especially in these decades of the new millennium. We are proud, said among others the World Bektashi Grandfather, to walk following the clear tracks of those Bektashi dervishes and babas who saw the destinies of their nation closely linked to the faith and to their devotion towards the Creator and made the Bektashism well known and beloved in different continents.

Meanwhile, in the American States Department the World Grandfather was received, among others, by the counselor of the strategic policies and initiatives on the issues of the religious freedom, Mrs. Mariyam Ceventvala, who firstly thanked the World Grandfather for the warm and fruitful conversation some months ago in Tirana. Further, Mrs. Ceventvala spoke about the initiative of the American State Department concerning the religious freedom and knowing the religious harmony in Albania, she appreciated the role of the Bektashi Holy See in this field. Mrs. Ceventvala said that not only in the Holy See in Tirana, but everywhere in the Bektashi communities, the Bektashi believers consider the issues and the problems of the faith in the framework of the universal human freedom, based on the international conventions, testifying tolerance and contemporary way of thinking.

After, the World Bektashi Grandfather, continuing his speech, spoke about the coordination of the points of view in order to elevate the historical responsibilities of the Bektashi Holy See, because this will serve not only to this tarikat but also to the fraternal spirit which it offers to the other communities. An official recognition more complete and a better juridical approach would influence that the World Bektashi Center play its complete role. In this context, we would welcome every idea or concrete aid from the American States Department, while our relations are becoming more closer from day to day; we are convinced that this encouragement will influence to the strengthening of the role and the contribution of the Bektashism.

Also, in the end of the meeting, the World Bektashi Grandfather, underlining the exercise of the universal and the religious freedom, spoke about the usurpation of the Bektashi teqe called "Harabati Baba", in the Northern Macedonia. A group of unconscious people, said the World Grandfather, incited by incriminated segments of the actual society, not only threaten the exercise of the religious freedom inside the historic Bektashi building

aged 500 years, but threaten also, physically, our lives, since 19-12 years.

Respecting the Bektashi principles of the wisdom and goodness, we tried to communicate always with the language of the reason and of the religion, with these apostates of the religion, aiming to safeguard the inestimable values of this ancient religious building. But, responding to our wise, religious attitude, the usurpers continue always with their physical threatening. Intolerable remains meanwhile the attitude of the Government of the Northern Macedonia, which, though has on the table the decision of the Strasbourg Court for the removal of the usurpers from the teqe, do not undertake any concrete action in order to execute the obligations and to respect the basic religious freedom. However, we will continue our efforts until the end, respecting always our religious spirit and the democratic laws into force.

During the days of the sojourn in USA, the World Bektashi Grandfather had several meetings with different religious leaders. While in New Jersey he was received by a community of Albanian businessmen, who were interested on investments in the Bektashi community.



URTËSIA

REVISTË FETARE SHOQËRORE ARTISTIKE

BOTIM I SELISË SË SHENJTË TË
KRYEGJYSHATËS BOTËRORE BEKTASHIANE

NR.137 SHKURT 2020